

NDIKIMI I KRIZËS TË SHKAKTUAR NGA KOVID -19 MBI PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA në Maqedonia e Veriut

Projekt: Iniciativa për demokraci në Ballkanin Perëndimor

Botues: Fondacioni Uestminster për demokraci, Maqedonia e Veriut

Për botuesin: Damir Neziri, Përfaqësues në vend i Fondacionit Uestminster për demokraci

Autorë:

Bojana Jovanovska

Natasha Petkovska

Lekturë dhe përkthim: Kongresen servisen centar

Redaktimi grafik: Studio dizajni KOMA

Përgatitja e kësaj analize është mbështetur nga Iniciativa për demokraci e Ballkanit Perëndimor – programi i Fondacionit Uestminster për demokraci. Përmbajtja e këtij dokumenti nuk pasqyron qëndrimet apo mendimet e Fondacionit Uestminster për demokraci apo të qeverisë Britanike.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA	4
PËRMBLEDHJE	7
HYRJE	13
METODOLOGJIA	19
1. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE KORNIZA NACIONALE JURIDIKE	24
1.1. Standardet ndërkombëtare	24
1.1.1. Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	25
1.2. Korniza nacionale juridike	29
1.2.1. Dekretet me fuqi ligjore gjatë kohëzgjatjes të gjendjes të jashtëzakonshme	32
2. TË DHËNAT NGA ANALIZA E PYETËSORËVE ME AKTORËT RELEVANT	49
Të dhënat e përgjithshme për aktorët e anketuar	49
2.1. Institucionet	50
2.2. Organizatat	51
Përfshirja e organizatave dhe institucioneve në procesin e miratimit të masave	52
Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në masa dhe pasqyrimi përkatës i nevojave të tyre	53
Arsimi	55
Shëndetësia	56
Mbrojtja sociale	57
Tregu i punës	58
Lëvizshmëria dhe transporti dhe qasja në informata	60
3. TË DHËNA NGA ANALIZA E PYETËSORËVE ME PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PERSONA QË KUJDESEN PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA	61
Të dhëna e përgjithshme për të anketuarit	61
Informimi dhe përfshirja	67
Realizimi i të drejtave	69
Shëndetësia	72
Mbrojtja sociale	74
Vendi i punës	77
Arsimi	79
Transporti dhe lëvizshmëria	81
Shpenzimet	84
Masat gjatë pandemisë	86
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	91
Literatura e shfrytëzuar	103
Legjislacioni	106

PARATHËNIA

Pasojat nga pandemia e KOVID-19 nuk e kanë shmangur Maqedoninë e Veriut. Pas stabilizimit nga efektet initiale të pandemisë, pasojat nga kriza shëndetësore-ekonomike mbi qytetarët filluan që të jenë pjesë e diskursit publik, analizave dhe politikave publike, me qëllim që të zvogëlohen implikimet e kushteve të reja mbi mirëqënien e njerëzve. Për fat të keq, një grup i madh i qytetarëve kanë mbetur të lënë pas dore, të marginalizuar në diskurs, ashtu si edhe në fakt, shpesh ndodh me pozitën e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Qytetarët me aftësi të kufizuara ende përballen me diskriminim, edhe krahas ratifikimit të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në OKB dhe në përditshmëri përballen me pengesa të vendosura nga shoqëria për pjesëmarrjen e tyre të tërësishme dhe të gëzuarit e të drejtave të njëjta si bashkëqytetarët e tyre. Pandemia veçanërisht ka goditur këto qytetarë, por edhe personat që kujdesen për to. Qytetarët në këtë grup më së shpeshti kanë status më të ulët social, pozitë jo të favorshme ekonomike, sfida në qasje në arsim dhe pothuajse janë të përjashtuar nga proceset politike. Personat me aftësi të kufizuara, për numrin e të cilëve mungojnë të dhëna të sakta, shpesh janë persona të cilët kanë sëmundje kronike, dhe me këtë edhe në aspekt shëndetësor janë nën rrezik të madh nga virusi.

Me qëllim që personat me aftësi të kufizuara të vendosen në fokus, të hidhet dritë mbi mënyrën në të cilën ndikon kriza mbi pozitën e tyre në shoqëri dhe cilat mësimet dhe ndryshime mund të nxirren nga kjo, Fondacioni i Uestminster për demokraci ka mbështetur përgatitjen e kësaj analize.

Analiza e përgatitur nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut ka për qëllim që të tregojë se në cilën mënyrë kriza ka goditur personat me aftësi të kufizuara dhe ata që kujdesen për këto persona, në cilën mënyrë ka ndryshuar jetën e tyre dhe qasjen në shërbimet publike. Ajo analizon dhe sa janë marrë parasysh nevojat e tyre gjatë krijimit të masave për mbrojtje të popullsisë nga koronavirusi. Elementi kryesor i kësaj analize janë rekomandimet dhe përpjekja

që të nxirren përfundime për atë se si institucionet mund të mbështesin dhe të kujdesen për këto qytetarë në periudhën që vijon, por edhe në raport me efektet afatgjate pas krizës.


Përgatitja e analizës është mbështetur përmes Inicativës për demokraci në Ballkanin Perëndimor, të realizuar nga Fondacioni i Uestminster për demokraci, kurse është financuar nga Qeveria e Britanisë të Madhe. Ju shprehim mirënjohje autoreve për analizën dhe Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, si dhe për mbështetjen nga ana e ekipit të Polio Plus gjatë të konceptuarit të këtij punimi dhe konsultimet për përmbajtjen e tij. Shpresojmë se ky dokument do u shërbejë institucioneve që t'u kthehen problemeve nga kriza për personat me aftësi të kufizuara dhe për krijimin e politikave publike për to dhe nxitje për krijimin e masave për mbështetje gjatë krizës për këtë grup. Dëshirojmë që ky dokument të jetë përkrahje për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim që të merren parasysh gjatë krijimit të të gjithë politikave të ardhshme nga ana e institucioneve, si qasje horizontale dhe e patejkalueshme, për krijimin e shoqërisë të qasshme për të gjithë qytetarët.



Damir Neziri,
përfaqësues në vend
Fondacioni i Uestminster për Demokraci

” PËRMBLEDHJE





Personat me aftësi të kufizuara paraqesin një nga grupet më të marginalizuara në çdo shoqëri. Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, me mbështetje të Fondacionit Uestminster për demokraci, ka realizuar një hulumtim të shkurtër për ndikimin e krizës nga pandemia e KOVID -19 mbi personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut nga shpallja e gjendjes të jashtëzakonshme, dhe deri tani. Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e të dhënave të disponueshme të gjeneruara dhe të grumbulluara dhe zbutja e implikimeve negative të krizës të shkaktuar nga KOVID -19 mbi mirëqënien e personave me aftësi të kufizuara, përmes rekomandimeve konkrete për miratimin e politikave. Hulumtimi e jep kontributin e tij për një analizë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të ndikimit të krizës mbi personat me aftësi të kufizuara, të përgatitur përmes triangulimit të të dhënave nga dokumentet zyrtare, literatura ekzistuese dhe të dhënat primare, të fituara nga intervistat me aktorët relevant dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe personat të cilët kujdesen për to.

Ky hulumtim e vërteton pozitën e marginalizuar në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to, dhe kjo është shprehur sidomos gjatë kohës të pandemisë. Hulumtimi tregon se në procesin e përgatitjes dhe miratimit të masave, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë i referohen personave me aftësi të kufizuara, nuk ishin përfshirë as personat me aftësi të kufizuara, as shoqatat e qytetarëve të cilat punojnë në këtë

Ky hulumtim e vërteton pozitën e marginalizuar në të cilën ndodhen personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to, dhe kjo është shprehur sidomos gjatë kohës të pandemisë

fushë. Vetëm se pas reagimeve të parashtruara dhe kërkesave të shoqatave, janë bërë ndryshime të masave, por pas miratimit të tyre nga ana e Qeverisë. Masat e miratuara i kanë injoruar nevojat specifike për personat me aftësi të kufizuara, sidomos të atyre që jetojnë në mjediset rurale. Duke marrë parasysh se ekziston një mungesë serioze e statistikës për personat me aftësi të kufizuara në vend dhe se ende nuk është vendosur regjistri për evidencën e tyre pranë Ministrisë për punë dhe politikë sociale, nuk disponojmë me informata përkatëse për llojet e aftësitve të kufizuara respektivisht pengesave

**Personat
me aftësi të
kufizuara dhe
personat që
kujdesen për to
janë përballur
me vështirësi në
realizimin e të
drejtave të tyre
gjatë pandemisë**

të këtij grupi të qytetarëve, që kontribuon për atë që të mos mund të përgatiten masa përkatëse që do të përgjigjen në nevojat e tyre.

Për pjesën më të madhe të personave me aftësi të kufizuara, masat për parandalim dhe mbrojtje nga virusi u kanë shkaktuar vështirësi në funksionimin e përditshëm. Vështirësitë i referohen socializimit të kufizuar dhe lëvizjes të kufizuar, si dhe në vështirësitë që lidhen me ndjekjen e masave për mbrojtje (mbajtjen e distancës fizike, mbajtjen e maskës, shmangien e grupimit etj.). Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballur me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjatë pandemisë, prej të cilave vetëm një pjesë e vogël janë drejtuar për ndihmë, më së shpeshti në qendrat për punë sociale, kurse pjesa më e vogël kanë kërkuar ndihmë nga shoqatat qytetare. Vetëm një pjesë e vogël e kanë marrë ndihmën e kërkuar, respektivisht kanë realizuar të drejtat e kërkuara.

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë përballur me probleme serioze gjatë ndjekjes të mësimin onlajn, që në masë të madhe nuk ishte përkatës dhe i përshtatur për to dhe llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara. Realizimi i mësimin realizohej në mungesë të mjeteve përkatëse ndihmëse arsimore, respektivisht mospasje të pajisjes të nevojshme teknike për realizimin e mësimin, si dhe mungesë të mbështetjes përkatëse për ndjekjen e mësimin (ndihmës arsimor, edukator special etj.).

Institucionet shëndetësore ishin lënë tërësisht në funksion të tejkalimit të pasojave nga pandemia, kurse të gjithë kontrollat tjera vijuese dhe intervenimet ishin shtyrë. Shërbimet për rehabilitim, të cilët janë të rëndësishë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dhe ndikojnë pozitivisht mbi zhvillimin e tyre, nuk ishin të disponueshme për një numër të madh të personave me aftësi të kufizuara. Madje edhe pikat për testim për KOVID-19 nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Edhe krahas përshtatjeve të bëra në lidhje me sigurimin e shërbimeve të caktuara shëndetësore, para së gjithash të lidhura me vazhdimin e vlefshmërisë të dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e ndonjë të drejte të mbrojtjes shëndetësore, një pjesë e madhe e të anketuarve janë përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes shëndetësore gjatë kohës të pandemisë. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballë me turma njerëzish dhe pritje të rradhëve në institucionet shëndetësore dhe në farmaci, dhe kjo në mënyrë serioze e rrit rrezikun e infektimit me virus. Në mënyrë shtesë, duke marrë parasysh se personat me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në lidhje me respektimin e masave për mbrojtje nga virusi, siç janë, për shembull, mbajtja e maskës, rreziku nga infektimi mund të rritet në mënyrë të konsideruar edhe për to, por edhe për personat tjerë. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to kanë shprehur pakënaqësinë në lidhje me profesionalizmin e punëtorëve shëndetësorë dhe mënyrën e komunikimit të ndërsjellë, duke theksuar mosdurimin dhe mosnjohjen e nevojave specifike që kanë ato.

Një nga problemet më të shpeshta me të cilat janë përballur personat me aftësi të kufizuara në lidhje me qasjen në shërbime të mbrojtjes sociale rrjedh nga pamundësia për shfrytëzimin e shërbimeve të qendrave ditore. Edhe pse, në ndërkohë, qendrat ditore kanë filluar me punë, megjithatë puna e tyre është me kapacitet të kufizuar, kurse transporti i kufizuar deri te qendrat është ende i kufizuar. Profesionalizmi nga ana e personave profesional, si dhe organizimi i administratës për sigurimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale është në nivel të ulët, respektivisht të anketuarit mendojnë se është i nevojshëm përmirësimi në këtë fushë në drejtim të zhvillimit pozitiv të qasjes në shërbime. Gjatë

kohës të pandemisë në mënyrë të konsideruar janë shprehur vështirësitë gjatë grumbullimit dhe ripërtrirjes të dokumenteve për realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, kurse në disa raste kjo ka çuar deri te humbja e të drejtës për realizimin e tyre. Korniza e përkufizuar ngushtë për mbrojtje sociale ka kontribuar për atë që një numër i madh i personave me aftësi të kufizuara që nuk përmbushin kushtet për mbështetje në para, kurse për shkak të krizës kanë mbetur pa apo me të ardhura të zvogëluara, apo kanë humbur punën, që të përballen me rrezik të rritur social dhe varfëri.

Pandemia në mënyrë të pashmangshme është pasqyruar edhe në gjendjen financiare të personave me aftësi të kufizuara, e ndërkohë ka rritur në mënyrë të konsideruar shpenzimet që i referohen parandalimit të shëndetit, duke përfshirë shpenzimet për mjetet higjienike dhe për ilaçet. Nevoja për furnizimin e ilaçeve që nuk ndodhen në listën pozitive të ilaçeve të Fondit për sigurim shëndetësor, si dhe për ato që nevojitet terapia e furnizojnë nga jashtë shtetit. Vështirësitë me të cilat janë përballur personat që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara në vendin e punës gjatë pandemisë në masë më të madhe i janë referuar mungesës nga puna për shkak të kujdesit për personin me aftësi të kufizuara në shtëpi.

Problemi i qasjes të kufizuar apo vështirësuar deri te institucionet me të cilat çdo ditë përballen personat me aftësi të kufizuara ishte shprehur në mënyrë të konsideruar gjatë kohës të pandemisë, dhe kjo ka të bëjë me funksionimin e reduktuar të institucioneve dhe në kufizimin e transportit gjatë kësaj periudhe. Një pjesë e personave nuk kishin mundësinë që të përdorin transportin publik për shkak të pamundësisë që të mbajnë maska dhe që tërësisht të respektojnë masat për mbrojtje nga virusi. Vetëm një pjesë e vogël e institucioneve në tërësi janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, dhe kjo përfshin edhe qasshmërinë në informata në ato institucione.



”” HYRJE



Në 11 mars të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka shpallur pandeminë për shkak të koronavirusit (virusit korona) të ri,¹ disa muaj pasi që virusi është paraqitur në Republikën Popullore të Kinës dhe është zgjeruar në pjesët tjera të botës.² Pas paraqitjes të disa rasteve pozitive të diagnostifikuara me KOVID-19 te ne, Qeveria ka miratuar një pako të masave dhe rekomandimeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona.³ Për shkak të përhapjes të shpejtë të virusit, në 18 mars të vitit 2020 është shpallur gjendja e jashtëzakonshme në territorin e të gjithë shtetit.⁴ Kohëzgjatja e gjendjes të jashtëzakonshme është vazhduar disa herë, për herë të fundit nga 15 deri në 22 qershor.⁵

Në fillimin e pandemisë, OBSH ka paralajmëruar se ekziston rrezik i madh nga infektimi me virusin te personat me aftësi të kufizuara. Kjo është si rrjedhojë e pengesave ekzistuese për zbatimin e masave themelore për mirëmbajtjen e higjienës, vështirësitë për mirëmbajtjen e distancës për shkak të nevojës për mbështetje shtesë apo jetesë në institucion, nevoja për prekje si mënyrë për pranimin e informatave nga mjedisi jetësor dhe probleme të mëparshme

- 1 Organizata botërore e shëndetësisë (2020, mars). *WHO Director-General's opening remarks at the media briefing on COVID-19 - 11 March 2020*. E disponueshme në: <https://www.who.int/dg/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---11-march-2020>.
- 2 Organizata botërore e shëndetësisë (2020). *Timeline: WHO's COVID-19 response*. E disponueshme në: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/interactive-timeline#event-0>.
- 3 Masat qeveritare dhe përfundimet për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona janë të disponueshme në faqen zyrtare të Qeverisë në këtë link: <https://vlada.mk/covid19?fbclid=IwAR3GJzpZ80e1pN1xFXSHxNAkaLDaBfcN650NSmjTCTDNPVxcmRjgTX2V1Xk>.
- 4 *Vendimi për vërtetimin e ekzistimit të gjendjes të jashtëzakonshme të datës 18.3.2021 i Presidentit të Republikës të Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut" nr. 68/2020)*.
- 5 Petkovksa N (2020, 30 nëntor). *Pasqyra e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona dhe ndikimi i tyre mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenczi%dl%98a-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%dl%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

shëndetësore.⁶ Situata në të cilën janë sjellur personat me aftësi të kufizuara si rezultat i drejtëpërdrejtë i pandemisë është vetëm tregues i dobësive ekzistuese të sistemit të shërbimeve publike dhe qasjes jo të barabartë deri te të për kategoritë e caktuara të rrezikuara.⁷

Edhe pse pandemia e shkaktuar nga KOVID -19⁸ ka prekur të gjithë, masat për trajtimin dhe pasojat e shkaktuara nga të qëniti (jo)përkatës, në mënyrë të ndryshme dhe jo të barabartë janë pasqyruar në kategoritë e ndryshme të qytetarëve. Kështu, kriza me virusin korona vetëm ka intensifikuar dhe ka nxjerr në sipërfaqe problemet me të cilat përballen në përditshmëri personat me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre dhe personat që kujdesen për to. Një pjesë e sfidave për personat me aftësi të kufizuara, të cilat kanë ekzistuar për një kohë të gjatë para pandemisë, i referohen stereotipeve dhe paragjyqimeve të cilat janë gjithnjë e më të pranishme në shoqërinë tonë, infrastruktura që nuk është e qasshme, praktikat diskriminuese në sistemin arsimor dhe në tregun e punës, por edhe institucionet që nuk janë llogaridhënëse. Treguesit për pengesat në funksionimin e përditshëm të personave me aftësi të kufizuara para pandemisë janë edhe të dhënat se ata janë ndërmjet grupeve të qytetarëve të drejtat e të cilëve më së shpeshti shkilen dhe përballen me diskriminim.⁹ Në periudhën nga gushti i vitit 2016 deri në janar të vitit 2018 në Komitetin e Helsinkit për të drejtat e njeriut janë dokumentuar 13 raste nga gjithsej 61 kërkesa për ndihmë juridike, ku personat kanë përjetuar diskriminim në bazë të aftësive

6 Organizata botërore e shëndetësisë (16 mars, 2020). *Disability considerations during the COVID-19 outbreak*. E disponueshme në: <https://www.who.int/publications-detail/disability-considerations-during-the-covid-19-outbreak>.

7 Organizata e Kombeve të Bashkuara (23 prill, 2020). *COVID-19 and Human Rights - We are all in this together*. E disponueshme në: https://www.un.org/development/desa/disabilities/wp-content/uploads/sites/15/2020/04/un_policy_brief_on_human_rights_and_covid_23_april_2020.pdf.

8 Sëmundje e shkaktuar nga virusi korona SARS-COV-2.

9 Jadrovski, I., Çalovska Dimovska, N. Dhe Jovanovska Kanurkova, J. (2018). *Raporti për ndihmën juridike të siguruar, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut*. E disponueshme në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/IZVESTAJ_ZA_PRAVNA_POMOS.pdf.

të kufizuara fizike dhe intelektuale.¹⁰ Në më shumë se 20 përqind nga numri i përgjithshëm i kërkesave të regjistruara, personat me aftësi të kufizuara janë përbërës me paqasshmëri të institucioneve dhe organeve që sigurojnë të mira publike dhe shërbime.¹¹ Përveç asaj, në periudhën nga gushti i vitit 2019 deri në korrik të vitit 2020 janë evidentuar 13 raste të diskriminimit dhe shkeljes të të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, respektivisht të prindërve të tyre apo personave që kujdesen për to, prej të cilëve pjesa më e madhe e kërkesave ishin lidhur me procesin arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe shfrytëzimin e të drejtave në vendin e punës nga ana e personave të cilët kujdesen për personat me aftësi të kufizuara.¹²

Sfidat e përmendura për personat me aftësi të kufizuara ishin theksuar në mënyrë të konsideruar nga trajtimi jo përkatës me pandeminë e shkaktuar nga KOVID-19. Mos-informimi për sëmundjen e KOVID-19, mbyllja e qendrave ditore¹³, mësimdhënia jo e përshtatur në distancë dhe pamundësia që të sigurohet masa për distancën e nevojshme të personat që varen nga mjetet ndihmëse për funksionimin e pandërprerë janë vetëm disa nga problemet që kanë prekur përditshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.¹⁴

10 Po aty, fq. 7.

11 Po aty, fq. 10.

12 Jovanovska, B. (2020). *Përforsimi juridik në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: raport*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/finalen-izveshta%D1%98-uniczef-mk.pdf>.

13 Shërbimi i vetëm për mbështetje që është në dispozicion për familjet është pikërisht qendra ditore për fëmijët me nevoja të kufizuara. Ky shërbim shfrytëzohet nga 10 % i fëmijëve në territorin e të gjithë vendit, para së gjithash, për shkak të kapacitetit të vogël dhe për shkak të padisponueshmërisë të shërbimit. Shërbimet dhe aktivitetet që ofrojnë ato shërbime nuk përputhen me nevojat e fëmijëve në pajtim me shkallën e zhvillimit të tyre. Shihni më shumë në Mihajlova, N., Ilieva, D., Mihajlov, S. Dhe Jovanova Jandrijevska, K. (2015, dhjetor). *Vlerësimi i formave alternative të përkujdesjes dhe shërbimet për mbështetjen e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara*. UNICEF. I disponueshëm në: <https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3731/file>.

14 Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. (2020, 13 tetor). *Raporti i veçantë për gjendjen e të drejtave të njeriut gjatë kohës të Kovid-19*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshta%D1%98-za-sosto%D1%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>.

Qëllimi i hulumtimit është që të analizojë të dhënat e disponueshme të gjeneruara dhe të grumbulluara edhe përmes rekomandimeve konkrete për miratimin e politikave që të kontribuohet për zbutjen e implikimeve negative të krizës të shkaktuar nga KOVID -19 mbi mirëqënien e personave me aftësi të kufizuara në fushën e mbrojtjes shëndetësore, arsimit, tregut të punës, përfshirjes shoqërore dhe të drejtave të njeriut. Hulumtimi kontribuon për një analizë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të ndikimit të krizës mbi personat me

Hulumtimi kontribuon për një analizë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të ndikimit të krizës mbi personat me aftësi të kufizuara

aftësi të kufizuara, të përgatitur përmes triangulimit të të dhënave nga dokumentet zyrtare, literaturës ekzistuese dhe të dhënat primare të fituara nga intervistat me aktorët relevant dhe personat me aftësi të kufizuara.

Në fokusin e këtij hulumtimi është ndikimi i krizës mbi jetën e përditshme të personave me aftësi të kufizuara, në përgjithësi, si dhe ndikimi i politikave të miratuara që i referohen qasjes të tyre në të drejta dhe shërbime, më konkretisht. **Në pjesën**

e parë, hulumtimi analizon rregullativën pozitive ligjore dhe standardeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Veçanërisht, kjo pjesë shqyrton Dekretet me fuqi ligjore të miratuara gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme të cilat (nuk) përfshin personat me aftësi të kufizuara dhe analizon zbatimin e tyre në praktikë. **Pjesa e dytë** analizon përgjigjet e të anketuarve – aktorët relevant, të nevojshme për shqyrtimin e ndikimit të pandemisë mbi personat me aftësi të kufizuara. **Në pjesën e tretë** përmbahen përvojat personale të drejtëpërdretja të personave me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to në raport me pasojat e përjetuara nga pandemia dhe masat jo përkatëse për trajtimin e saj. Përfundimisht, në fund kemi **përfundimet dhe rekomandimet** për zbutjen e efekteve negative nga kriza mbi personat me aftësi të kufizuara, si dhe miratimin e politikave që do të marrin parasysh rethanat e tyre specifike.





METODOLGJIA



Qëllimi i kësaj analize është që të identifikohen efektet që i kishte pandemia e shkaktuar nga virusi KOVID-19, respektivisht masat që janë miratuar si rezultat i pandemisë mbi jetën e përditshme të personave me aftësi të kufizuara përmes qasjes deri te të drejtat e caktuara dhe shërbimet në disa fusha të caktuara gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën kohë, kjo analizë ka për qëllim që të jap udhëzime dhe rekomandime përkatëse për krijimin e masave që do të jenë përkatëse për nevojat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe personat të cilët kujdesen për to.

Në drejtim të realizimit të qëllimeve të këtij hulumtimi, metodologjia që ishte e nevojshme përbëhej nga zbatimi i metodave sasiore dhe cilësore për grumbullimin e të dhënave primare dhe sekondare.

Analiza ka përfshirë këto fusha:

- ▶ Përfshirje në proceset e krijimit të masave
- ▶ Qasje në informata
- ▶ Shëndetësia
- ▶ Mbrojtja sociale
- ▶ Arsimi
- ▶ Puna dhe marrëdhëniet e punës
- ▶ Shpenzimet
- ▶ Qasshmëria, transporti dhe lëvizshmëria

Për zotërimin e suksesshëm dhe anlizën e lëndës të këtij hulumtimi janë zbatuar disa instrumente hulumtuuese:

1. ANALIZA E PËRMBAJTJES (DESK-ANALIZA)

Lënda e hulumtimit dhe arritja e qëllimit të tij janë të arritura me sukses me përdorimin e metodave themelore të hulumtimit: analiza e standardeve ndërkombëtare të metodave themelore të hulumtimit: analiza e standardeve ndërkombëtare dhe korniza ligjore nacionale që është relevante për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara (deks-analiza). Këto dokumente janë interpretuar në pajtim me kuptimin e zakonshëm të fjalëve të përdorura, me çrast është marrë parasysh kuptimi i tyre për personat me aftësi të kufizuara gjatë gjendjes të jashtëzakonshme dhe rethanat e jashtëzakonshme.

2. PYETËSOR PËR AKTORËT RELEVANT

Pyetësorët ishin dërguar në formë elektronike deri te të gjithë aktorët e identifikuar relevant, respektivisht institucionet dhe organizatat që drejtpërdrejtë punojnë apo në mënyrë të tërthortë janë të lidhur me personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to. Pyetësorët ishin dërguar gjatë shkurtit të vitit 2021. Përgjigjet ishin grumbulluar drejtpërdrejtë pas dërgimit, kurse përgjigja e fundit ishte dorëzuar në mars të vitit 2021.

Duke patur parasysh sfondin e ndryshëm të aktorëve¹⁵, pyetjet ishin përshtatur në mënyrë përkastëse në fushën dhe mandatin e veprimit të aktorëve të caktuar. Nga pyetjet që ishin dërguar deri te gjithsej 15 organizata që punojnë në këtë fushë, informacion kthyes është marrë nga pesë shoqata vendore të qytetarëve dhe një organizatë ndërkombëtare. Pyetësorët e destinuar për instiucionet ishin dërguar drejtpërdrejtë deri te 12 institucione, nga të cilat ishte marrë përgjigje kthyes vetëm nga një ministri dhe dy institucione arsimore. Është veçanërisht e rëndësishme të përmendet se është marrë vendim që të mos përdoret mekanizmi i kërkesës për qasje në informata të karakterit publik, sepse afat ligjor prej 30 ditësh për përgjigje nga ana e institucioneve

¹⁵ Institucionet shtetërore dhe arsimore, shoqatat e qytetarëve dhe organizatat ndërkombëtare.

ka tejkeluar afatin kohor për grumbullimin e këtyre të dhënave, sidomos duke patur parasyh përvojat e deritashme se institucionet shumë shpesh tejkalojnë këtë afat kohor për dorëzim të informatave.

Është e rëndësisë të veçantë të përmendet se janë investuar përpjekje të konsideruara për marrjen e përgjigjeve në pyetësor përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, megjithatë institucionet nuk i dorëzuan përgjigjet.

3. PYETËSOR PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PËR PERSONA QË KUJDESEN PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ky pyetësor përbëhej nga gjithsej 44 pyetje që kanë përfshirë disa fusha në lidhje me funksionimin e përditshëm të të anketuarve dhe qasjen në të drejta dhe shërbime gjatë kohës të pandemisë. Anketa ishte realizuar gjatë shkurtit të vitit 2021. Fokusi është vendosur në qasjen në të drejta dhe shërbime për informim, shëndetësi, arsim, mbrojtje sociale, treg të punës, si dhe përfshirjen në miratimin e masave në lidhje me pandeminë. Në të njëjtën kohë, përmes pyetësorit është dhënë mundësia që të anketuarit të theksojnë propozimet dhe rekomandimet e tyre për zvogëlimin dhe sanimin e efekteve negative që i kishin masat e caktuara, por edhe vetë pandemia, si dhe propozimi për trajtimin më të mirë të implikimeve negative në të ardhmen.

Pjesa më e madhe e pyetësorëve ishin realizuar onlajn,¹⁶ të cilat ishin të disponueshme në gjuhën maqedonase dhe shqipe, kurse pjesë më e vogël përmes telefonit nga ana e anketuesit. Për ndarjen e pyetësorit janë shfrytëzuar listat ekzistuese të kontaktit, rrjetet sociale dhe ueb faqet. Të anketuarit që janë anketuar në formë telefonike ishin lutur që ta dërgojnë linkun edhe te persona të tjerë që përmushin kushtet për anketim dhe për të

¹⁶ Pyetësori është i disponueshëm në ueb-faqen e Komitetit të Helsinikut për të drejtat e njeriut: <https://mhc.org.mk/news/prashalnik-za-lica-so-poprechenost-i-lica-koi-se-grizhat-za-lica-so-poprechenost-pyetesor-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-personat-qe-kujdesen-per-personat-me-aftesi-te-kufizuara/>

cilët konsiderojnë se do të ishin të interesuar që të plotësojnë pyetësin. Në ditët e fundit nga grumbullimi i të dhënave, pyetësi onlajn, i cili ishte dërguar deri te Ministria e punës dhe politikës sociale, përmes disa qendrave ditore është dërguar edhe deri te personat që kujdesen për përdoruesit që përdorin shërbimet e qendrave ditore.

Pyetësi është plotësuar gjithsej nga 218 të anketuar, prej të cilëve 59 janë persona me aftësi të kufizuara, kurse 159 janë persona që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara. Duke marrë parasysh kohën e kufizuar dhe resurset për realizimin e hulumtimit, por edhe specifikimet e grupit të synuar dhe qasja deri te të anketuarit duke patur parasysh kufizimet për realizimin e kontakteve të imponuara me pandeminë, për qëllimet e këtij hulumtimi është shfrytëzuar ekzemplar pa përzgjedhje të rastësishme, respektivisht ekzemplar të përshtatur. Sipas kësaj, të anketuarit që ishin përfshirë në ekzemplar ishin zgjedhur nga ata që ishin në dispozicion të hulumtuesve. Përveç asaj, duke patur parasysh se ekziston një mungesë serioze e statistikës për popullsinë e synuar dhe se ende nuk është krijuar regjistri për evidencë të personave me aftësi të kufizuara pranë Ministrisë të punës dhe politikës sociale, është kufizuar edhe mundësia për krijimin e ekzemplarit përkatës për realizimin e hulumtimeve që janë të fokusuar në këtë popullsi.

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se rezultatet nga pyetësit nuk mund të përgjithësohen jashtë nga kufijtë e ekzemplarit, dhe kjo nuk paraqet kufizim të interpretimit të rezultateve të fituara. Edhe krahas asaj që ekzemplari është përfaqësues, gjetjet e fituara nuk mund të përgjithësohet për të gjithë grupin e synuar, megjithatë mund të jepen udhëzime për hulumtimet e mëtejshme, por që është më e rëndësishme, udhëzime për veprimin më përkatës gjatë marrjes të masave të reja në periudhën e ardhshme, sidomos duke marrë parasysh se pandemia e virusit KOVID-19 ende vazhdon.

4. TRYEZA E RRUMBULLAKËT ME AKTORË RELEVANT NGA SHOQËRIA CIVILE

Në 3 mars të vitit 2021 është mbajtur tryeza e rrumbullakët e dedikuar për organizatat, por edhe për individët që punojnë në fushën e personave me aftësi të kufizuara dhe persona që kujdesen për ta. Tryeza e rrumbullakët është mbajtur onlajn përmes platformës ZUM, në kohëzgjatje prej 2 orëve, në të cilën kanë marrë pjesë rreth 17 pjesëmarrës. Në tryezën e rrumbullakët janë përfaqësuar përfundimet që ishin nxjerrë në bazë të përpunimit të 70 % nga të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorëve për aktorët relevant dhe pyetësorët për personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to, si dhe draft-rekomandimet që kanë dal nga analiza e parë. Pas prezantimit të përfundimeve dhe rekomandimeve nga ana e hulumtuesve, pjesëmarrësit kishin mundësinë që të japin mendimet e tyre në lidhje me to, por edhe të ndajnë përvojat e tyre që nuk ishin përfshirë me të dhënat e deriatëhershme. Pas përfundimit të tryezës të rrumbullakët, rekomandimet ishin marrë parasysh në krijimin e rekomandimeve finale të kësaj analize.

1. STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE KORNIZA NACIONALE JURIDIKE

1.1. Standardet ndërkombëtare

Instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e garantojnë mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, pavarësisht faktit se ato kanë karakter univerzal dhe i referohen të gjithë njerëzve.¹⁷ Marrëveshjet e përgjithshme ndërkombëtare që përfshijnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mes të tjerash, janë Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut¹⁸, Pakti ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike¹⁹ dhe Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore²⁰. Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të personave me aftësi të kufizuara janë riafirmuar në Konventën e Organizatës të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara²¹. Kjo Konventë, rëndësia e të cilës në kontekst të pandemisë me virusin korona do të shqyrtohet në tekstin e mëposhtëm, afirmon konceptet e aftësisë të kufizuar si koncepte fleksibile dhe evolutive që i nënshtrohen zhvillimit të vazhdueshëm.²²

Në nivel ndërkombëtar, parimi univerzal përforcohet me parimin e barazisë dhe jodiskriminimit, të mishëruara në instrumentet për të drejtat e njeriut, siç janë

17 Secretariat for the Convention on the Rights of Persons with Disabilities. *Overview of International Legal Frameworks For Disability Legislation*. United Nations. E disponueshme në: <https://www.un.org/esa/socdev/enable/disovlf.htm#overleg2>.

18 Organizata e Kombeve të Bashkuara (10 dhjetor, 1948). Deklarata universale për të drejtat e njeriut.

19 Organizata e Kombeve të Bashkuara (16 dhjetor, 1966). Pakti ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike. Ka hyrë në fuqi në 23 mars të vitit 1976.

20 Organizata e Kombeve të Bashkuara (16 dhjetor, 1966). Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale, dhe kulturore. Ka hyrë në fuqi në 3 janar të vitit 1976.

21 Organizata e Kombeve të Bashkuara (13 dhjetor, 2006). Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ka hyrë në fuqi në 3 maj të vitit 2008.

22 Ortakovski, T., *Analiza për vlerësimin e programave dhe masave nacionale për punësimin e personave me aftësi të kufizuara*. Misioni i OSBE-së në Shkup. E disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/7/5/372051.pdf>.

Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racor²³, Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit mbi gratë²⁴, Konventa kundër torturës the veprimit apo dënimit tjetër mizor, çnjerëzor dhe poshtërues²⁵, Konventa për të drejtat e fëmijës²⁶, Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre²⁷, dhe protokollet fakultative ndaj këtyre konventave.

1.1.1.1. *Konventat për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*

Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar Konventën e Organizatës të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në 30 mars të vitit 2007, kurse e

kanë ratifikuar në 5 dhjetor të vitit 2011.²⁸ Në 29 korrik të vitit 2009, shteti jonë ka nënshkruar Protokollin fakultativ ndaj Konventës, i cili ishte ratifikuar bashkarisht me Konventën.²⁹ Kushtetuta jonë, si akt më i lartë juridik, parasheh se marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rregullimit të brendshëm juridik dhe nuk mund të

23 Organizata e Kombeve të Bashkuara (21 dhjetor, 1965). Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racor. Ka hyrë në fuqi në 4 janar të vitit 1969.

24 Organizata e Kombeve të Bashkuara (18 dhjetor, 1979). Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit mbi gratë. Ka hyrë në fuqi në 3 shtator të vitit 1981.

25 Organizata e Kombeve të Bashkuara (4 shkurt, 1985). Konventa kundër torturës dhe veprimit apo dënimit tjetër mizor, çnjerëzor apo poshtërues. Ka hyrë në fuqi në 26 qershor të vitit 1987.

26 Organizata e Kombeve të Bashkuara (20 nëntor, 1989). Konventa për të drejtat e fëmijës. Ka hyrë në fuqi në 2 shtator të vitit 1990.

27 Organizata e Kombeve të Bashkuara (18 dhjetor, 1990). Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Ka hyrë në fuqi në 1 korrik të vitit 2003

28 Kuvendi i Republikës të Maqedonisë (5 dhjetor, 2011). Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokollin fakultativ ndaj konventës për të drejtat e personave me invaliditet. "Gazeta zyrtare e RM" numër 172 nga 14 dhjetori i vitit 2011.

29 Po aty.

ndryshohen me ligj.³⁰ Kjo do të thotë se dispozitat e përmbajtura në Konventë janë drejtëpërdrejtë të zbatueshme te ne. Për aq më tepër, për gjykatat tona është paraparë detyrimi që të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, që do të thotë se krijohet praktika gjyqësore e mbrojtjes të personave me aftësi të kufizuara.³¹

Konventa është instrumenti i parë zyrtar që shqyrton aftësinë e kufizuar përmes prizmit të të drejtave të njeriut dhe e mishëron modelin e saj social.³² Duke patur parasysh se të drejtat në Konventë janë univertale, të pandashme, të ndërvarura dhe të ndërlidhura, në mënyrë të pashmangshme paraqitet nevoja që të shqyrtohen dispozitat e saj në kontekst të situatës të re të krijuar të shkaktuar nga pandemia me virusin korona. Preambulla e Konventës dhe gjuha që është përdorur për përgatitjen e saj thekson ndryshimin nga sfera individuale në atë kolektive. Kjo do të thotë se vërehet braktisja e qëndrimit për pamundësinë individuale të personave me aftësi të kufizuara dhe fokus në pengesat shoqërore që pamundësojnë që ata të gëzojnë në tërësi të drejtat dhe liritë e tyre.³³ Në fakt, Preambulla njih dhe pranon se aftësia e kufizuar është “një koncept i ndarë dhe rezulton në ndërveprim ndërmjet individëve me pamundësi dhe pengesave në shoqëri dhe mjedis, të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre të tërësishme dhe efikase në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët”.³⁴

30 Kuvendi i Republikës të Maqedonisë (17 nëntor, 1991). Kushtetuta e Republikës të Maqedonisë. E shpallur me vendimin numër 08-4642/1. Neni 118.

31 Amendamenti XXV i Kushtetutës të Republikës të Maqedonisë.

32 „Modeli social sheh personat me aftësi të kufizuara si subjekte me të drejtat e tyre, dhe jo si objekte, dhe prandaj thekson respektimin e të drejtave të tyre në bazë të barabartë me personat tjerë në shoqëri. Ai fokusohet në pengesat në shoqëri dhe në mjedis, të cilat mund të pengojnë pjesëmarrjen e tërësishme dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët, dhe jo në pamundësinë individuale, respektivisht aftësinë e kufizuar *per se*.” Shihni më shumë në: Popovska ZH. (2018). *Interpretues i Konventës ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të Organizatës të Kombeve të Bashkuara*. E disponueshme në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf.

33 Po aty.

34 Paragraf d nga Preambulla e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Një nga parimet kryesore të mishëruara në Konventë është pikërisht nevoja për përfshirje aktive në proceset e marrjes të vendimeve në raport me politikat dhe programet, duke përfshirë ata që drejtëpërdrejtë u referohen atyre.³⁵ Edhe një parim që është përfshirë në Konventë është edhe njohja e rëndësisë të qasshmërisë në mjedisin fizik, social, ekonomik dhe kulturor, në shëndetësi dhe arsim, dhe në informata dhe komunikime.³⁶ Njëkohësisht, Preambulla e njuh familjen e personave me aftësi të kufizuara si njësi grupore shoqërore themelore dhe natyrore, që si e tillë ka të drejtë në mbrojtje të domosdoshme dhe ndihmë nga shoqëria dhe shteti për të gëzuar në tërësi dhe në mënyrë të barabartë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.³⁷ Konventa e ngren qasshmërinë në nivel të parimit themelor dhe parasheh se shtetet do të ndërmarrin masa përkatëse që të identifikojnë dhe të eliminojnë pengesat në qashtëmëri. Kjo nënkupton se shtetet duhet të bëjnë gjithçka që të sigurojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara, dhe atë në bazë të barabartë me të tjerët, deri te mjedisi fizik, transporti, informatat dhe komunikimet, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe të komunikimit, si dhe deri te kapacitetet tjera dhe shërbimet e hapura dhe të siguruara për publikun në mjediset urbane dhe rurale.³⁸

Konventa parasheh detyrimin e shteteve që të ndërmarrin të gjithë masat e nevojshme (në pajtim me detyrimet tjera ndërkombëtare-juridike) për mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut, duke përfshirë edhe situatat e jashtëzakonshme.³⁹ Ky është ndoshta detyrimi më i rëndësishëm që e jep Konventa në rethana të krizës të këtyre përmasave, të shkaktuara drejtëpërdrejtë nga pandemia me virusin korona. Më tutje, Konventa parasheh detyrimin themelor të shteteve nënshkruese gjatë

35 Po aty, Paragrafi l.

36 Po aty, Paragrafi s.

37 Po aty, Paragrafi q.

38 Po aty, neni 9.

39 Po aty, neni 11.

zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe politikave, si dhe proceset tjera të marrjes të vendimeve të cilat i referohen personave me aftësi të kufizuara, drejtëpërdrejtë të konsultohen me personat me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë aktive t'i përfshijnë, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara përmes organizatave të cilat i përfaqësojnë.⁴⁰ Me këtë detyrim padyshim se janë të përfshira proceset e miratimit dhe zbatimit të rregullave dhe politikave për trajtimin e pandemisë. Njëkohësisht, përmes të gjithë tekstit të dispozitave të Konventës përcaktohet detyrimi i shteteve që të konsultohen, të komunikojnë dhe të përfshijnë shoqërinë civile në proceset e marrjes të vendimeve. Kjo është theksuar veçanërisht në nenin 33 nga Konventa, i cili parasheh përfshirjen aktive të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese në procesin e ndjekjes të zbatimit të Konventës.⁴¹

Nga përgjigjet e të anketuarve – organizatave relevante që përfaqësohen dhe i përfaqësojnë interesat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to – rrjedh se shteti jonë, edhe krahas faktit që ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën, nuk respekton asnjë nga detyrimet e parapara.⁴² Në fakt, masat që janë miratuar nga vetë fillimi i pandemisë nuk i kanë pasqyruar nevojat e personave me aftësi të kufizuara, dhe rrjedhimisht nuk kanë patur sukses që të sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë e tyre përkatëse dhe të tërësishme. Në masë të madhe, masat nuk ishin përkatëse pikërisht për shkak të mospërbushjes të detyrimit të shtetit që të përfshijë personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat përfaqësuese në procesin e vendimarrjes.

⁴⁰ Po aty, neni 4 paragrafi 3.

⁴¹ Po aty, neni 33 paragrafi 3.

⁴² Shihni fq. 13-18.

1.2. Korniza nacionale juridike

Kushtetuta jonë u garanton qytetarëve të Republikës të Maqedonisë së Veriut barazi në të drejtat dhe liritë pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës të lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, bindjes politike dhe besimit fetar, pozitës pronësore dhe shoqërore. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe para ligjeve.⁴³ Aftësia e kufizuar nuk është paraparë ndërmjet bazave të mbrojtura të përmendura në këtë dispozitë kushtetuese. Më tutje Kushtetuta parashihet se Republika kujdeset për mbrojtjen sociale dhe sigurinë sociale të qytetarëve në pajtim me parimin e drejtësisë sociale. Republika u garanton të drejtën e ndihmës qytetarëve që janë të pafuqishëm dhe të paaftë për punë. Republika u siguron mbrojtje të veçantë personave invalidor dhe kushte për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.⁴⁴ Në këtë mënyrë, kushtetutvënësi ndan njerëzit me aftësi të kufizuara (në tekstin e dispozitës “persona invalidor”) si grup i veçantë i qytetarëve të cilëve u nevojitet mbrojtje e veçantë. Ndërkohë, dispozita implikon ndërmarrjen e masave afirmative me qëllim të realizimit të barazisë formale si kategori e garantuar me kushtetutë.⁴⁵

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi⁴⁶ përkufizon se personi me aftësi të kufizuara është personi që ka pamundësi afatgjate fizike, intelektuale, mendore apo sensorike, të cilat në ndërveprim me pengesat e ndryshme shoqërore mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të tërësishme dhe efektive në shoqëri në bazë të njëjtë me të tjerët.⁴⁷ Ky ligj në mënyrë eksplicite përfshin

43 Kuvendi i Republikës të Maqedonisë (17 nëntor, 1991). Kushtetuta e Republikës të Maqedonisë. E shpallur me vendim numër 08-4642/1. Neni 9.

44 Po aty, neni 35.

45 Koçoska, E. dhe të tjerë (2017). *Analiza e gjendjes me personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Анализа-на-состојбата-на-лицата-со-физичка-попреченост-во-Република-Македонија.pdf>.

46 Kuvendi i RMV (30 tetor, 2020). Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. “Gazeta zyrtare e RMV” nr.259/2020 e datës 30.10.2020.

47 Po aty, neni 4 paragrafi 1 pika 3.

personat me aftësi të kufizuara në spektrin e gjërë të mbrojtjes dhe listës të pashtershme të bazave të diskriminimit.⁴⁸ Ligji i referohet të gjithë personave fizik dhe juridik dhe zbatohet nga ana e të gjithë organeve shtetërore, organeve të njësisive të vetëqeverisjes lokale, personave juridike me autorizime publike dhe të gjithë personave tjerë fizik dhe juridik në të gjithë sektorët dhe fushat.⁴⁹ Ndërkohë, janë të ndaluara të gjithë format e diskriminimit, duke përfshirë edhe diskriminimin e drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë,⁵⁰ thirrjen, nxitjen dhe udhëzimin për diskriminim,⁵¹ shqetësimi,⁵² viktimizimi⁵³ dhe segregimi.⁵⁴ Si formë më e rëndë e diskriminimit, Ligji e konsideron diskriminimin e disahershëm, diskriminimin ndërseksional, diskriminimin e përsëritur dhe diskriminimin e vazhduar.⁵⁵ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi e përkufizon përshtatjen përkatëse, dhe atë si ndryshim dhe përshtatje të domosdoshme dhe përkatëse të nevojshme në rastin e caktuar, që nuk shkakton ngarkesën joproportionale apo të panevojshme, dhe me qëllim që të sigurohet të gëzuarit apo realizimi i të gjithë të drejtave dhe lirive të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, në bazë të barabartë me të tjerët. Ligji parasheh se pamundësimi i përshtatjes përkatëse është diskriminim.⁵⁶

Ligji për mbrotje sociale⁵⁷ rregullon sistemin dhe organizimin e mbrojtjes sociale, si dhe mënyrën në të cilën realizohen të drejtat e qytetarëve në fushën

48 Po aty, neni 5.

49 Po aty, neni 3.

50 Po aty, neni 8.

51 Po aty, neni 9.

52 Po aty, neni 10.

53 Po aty, neni 11.

54 Po aty, neni 12.

55 Po aty, neni 13.

56 Po aty, neni 3 paragrafi 1 pika 4.

57 Kuvendi i RMV (23 maj, 2019). Ligji për mbrojtjen sociale. Gazeta zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr.104/19, 146/19, 275/19, 302/20 dhe 311/20.

e mbrojtjes sociale.⁵⁸ Ligji përkufizon aftësinë e kufizuar dhe parasheh se personi me aftësi të kufizuar është personi që ka çregullime afatgjate trupore, intelektuale, mendore apo shqisore, të cilat në ndërveprim me pengesat e ndryshme mund të parandalojnë pjesëmarrjen e tij të tërësishme dhe efikase në shoqëri në bazë të njëjtë me të tjerët.⁵⁹ Përveç asaj, ky ligj rregullon mbrojtjen institucionale dhe jashtëinstitucionale të personave me aftësi të kufizuar dhe ndihmën në para.

Me Ligjin për mbrojtjen shëndetësore,⁶⁰ mes të tjerash rregullohen çështjet që i referohen sistemit dhe organizimit të mbrojtjes shëndetësore dhe ushtrimit të aktivitetit të shëndetësisë, si dhe cilësisë dhe sigurisë në veprimtarinë shëndetësore. Sigurimi shëndetësor i qytetarëve, të drejtat dhe detyrimet e sigurimit shëndetësor, si dhe mënyra e realizimit të sigurimit shëndetësor janë të rregulluara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore.⁶¹ Nga pjesëmarrja në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore janë të liruar fëmijët me pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike, sipas rregullave për mbrojtje të fëmijëve (mbrojtje shëndetësore) si dhe personat me sëmundje mendore të vendosur në spitale psikiatrike dhe personat me pengesa intelektuale pa kujdes shëndetësor.⁶²

58 Popovska. ZH. dhe të tjerë (2015). *Ligjet dhe politikat e Republikës të Maqedonisë në fushën e aftësisë të kufizuar*.

59 Ligji për mbrojtjen sociale, neni 4 paragrafi 1 pika 5.

60 Kuvendi i RM (29 mars, 2012). *Ligji për mbrojtjen shëndetësore*. „Gazeta zyrtare e RM“ nr.43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16, 20/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV “ nr. 101/19, 153/19, 180/19, 275/19 dhe 77/21.

61 Kuvendi i RM (3 mars, 2000). *Ligji për sigurimin shëndetësor*. „Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë “ nr. 25/00, 34/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37/06, 18/07, 36/07, 82/08, 98/08, 6/09, 67/09, 50/10, 156/10, 53/11, 26/12, 16/13, 91/13, 187/13, 43/14, 44/14, 97/14, 112/14, 113/14, 188/14, 20/15, 61/15, 98/15, 129/15, 150/15, 154/15, 192/15, 217/15, 27/16, 37/16, 120/16, 142/16, 171/17 dhe „Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 275/19 dhe 77/21), neni 1.

62 Ligji për sigurimin shëndetësor, neni 34 paragrafi 1, alinea 4.

Ligji për punësimin e personave invalidor⁶³ parasheh mjete financiare që sigurohen nga fondi i veçantë për përmirësimin e kushteve për punësim dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar.⁶⁴ Përveç asaj, Ligji parasheh mundësinë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin privat dhe publik, por e parasheh edhe mundësinë për vetëpunësim në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare. Është paraparë edhe themelimi i shoqatës mbrojtëse që bazohet në punësimin e personave me aftësi të kufizuara si subjekt ekonomik jashtë nga Ligji për shoqëritë tregtare.⁶⁵

1.2.1. Dekretet me fuqi ligjore gjatë kohëzgjatjes të gjendjes të jashtëzakonshme

Në 18 mars të vitit 2020 është shpallur gjendja e jashtëzakonshme në territorin e të gjithë shtetit, kurse kohëzgjatja e saj është vazhduar pesë herë.⁶⁶ Gjendja e jashtëzakonshme ka përfunduar në 22 qershor të vitit 2020.⁶⁷ Në rastet kur është shpallur gjendja, gjatë kohëzgjatjes të saj Qeveria ka autorizim që të sjellë dekrete me fuqi ligjore.⁶⁸ Derisa zgjaste gjendja e jashtëzakonshme, Qeveria e RMV ka miratuar 250 dekrete me fuqi ligjore, dhe atë dekrete për zbatimin e ligjeve të caktuara, dekrete për ndryshimin dhe plotësimin e dekreteve ekzistuese, dekrete burimore dhe dekrete për pushimin e vlefshmërisë të dekreteve të miratuara më parë.⁶⁹ Prej tyre, sipas materies që rregullojnë, 54

63 Kuvendi i RM [2 qershor, 2000]. *Ligji për punësimin e personave invalidor*. „Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë“ nr. 44/00, 16/04, 62/05, 113/05, 29/07, 88/08, 161/08, 99/09, 136/11, 129/15, 147/15, 27/16 dhe 99/18.

64 Popovska, ZH. dhe të tjerë (2015). *3 Ligjet dhe politikat e Republikës të Maqedonisë në fushën e aftësive të kufizuara*.

65 Ortakovski, T. *Analiza për vlerësimin e programeve nacionale dhe masave për punësimin e personave me aftësi të kufizuara*. Misioni i OSBE në Shkup. E disponueshme në: <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2018/02/372051.pdf>.

66 Shihni fusnotat 4 dhe 5.

67 Po aty.

68 Kuvendi i Republikës të Maqedonisë [17 nëntor, 1991]. *Kushtetuta e Republikës të Maqedonisë*. E shpallur me vendim numër 08-4642/1. Neni 126 paragrafi 1.

69 Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (2020). *Gjendja e jashtëzakonshme 18.03.2020-22.06.2020 pasqyra e Dekreteve të miratuara me fuqi ligjore*. E disponueshme në: <https://bit.ly/3a09oSL>.

dekrete i janë referuar ekonomisë dhe financave, 29 dekrete kanë rregulluar fushat e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, për rregullimin e procesit arsimor janë miratuar 19 dekrete, marrëdhëniet e punës janë përfshirë me 14 dekrete, kurse gjyqësori me 13.⁷⁰

Nga këtu, vlen të shqyrtohen dekretet relevante që në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe më së shumti prekin personat me aftësi të kufizuara dhe deri në cilën masë ata adresojnë nevojat e tyre. Shqyrtimi i këtyre dekretëve është bërë sipas fushës përkatëse që rregullojnë dekretet. Më pas, më detajisht janë analizuar dekretet që shprehimisht përmendin personat me aftësi të kufizuara dhe realizimin e të drejtave të tyre gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme. Për shqyrtim më të mirë të tekstit, të gjithë dekretet relevante me fuqi ligjore do të prezantohen në tabela në fund të secilës pjesë në fushën përkatëse.

1.2.1.1. Dekretet që prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por megjithatë nuk adresojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara

ARSIMI

Gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme, procesi arsimor realizohej në pajtim me dekretet me fuqi ligjore për zbatimin e ligjeve për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe dekretet për ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Prej tyre, më relevante ishin dekretet themelore për zbatimin e ligjit në shkallën përkatëse të arsimit. E kështu, me këto dekrete është vërtetuar se mësimdhënia në shkollat fillore dhe të mesme organizohet përmes mësimin në distancë, respektivisht mësimin nga shtëpia me zbatimin e mjeteve për komunikim elektronik. Përveç asaj, edhe programet studimore për fitimin e arsimit të lartë në të tre ciklet e enteve të arsimit të lartë dhe kontrollimi i njohurive të studentëve realizohen përmes sistemit për mësim në distancë me zbatimin e mjeteve për komunikim elektronik.

⁷⁰ Po aty.

Asnjë nga këto dekrete, as dekretet për ndryshimet dhe plotësimet e tyre nuk kanë mbuluar realizimin e mësimdhënies përmes mësimit në distancë me zbatimin e mjeteve për komunikim elektronik për nxënësit me aftësi të kufizuara. Hartuesit e dekreteve nuk kanë marrë parasysh nevojat për platformën përkatëse për arsim onlajn, përshtatjen e mësimdhënies onlajn për personat me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, nevoja për teknologji ndihmëse dhe nevoja për edukator special dhe social, rehabilitator dhe kuadër arsimor për mbështetje të fëmijëve për ndjekjen e mësimdhënies nga shtëpia. Në këtë mënyrë, shteti ka lënë pas dore detyrimin e tij për përshtatje përkatëse.

Qeveria e RMV	24 mars 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim fillor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.76 e datës 24.3.2020
Qeveria e RMV	24 mars 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të mesëm gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.76 e datës 24.3.2020
Qeveria e RMV	24 mars 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.76 e datës 24.3.2020
Qeveria e RMV	5 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim fillor gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.116 e datës 5.5.2020

Qeveria e RMV	5 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të mesëm gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.116 e datës 5.5.2020
Qeveria e RMV	18 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim fillor gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.128 e datës 18.5.2020
Qeveria e RMV	18 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të mesëm gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.128 e datës 18.5.2020
Qeveria e RMV	22 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.134 e datës 22.5.2020
Qeveria e RMV	5 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsim të lartë gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.149 e datës 5.6.2020

MBROJTJA SOCIALE

Në 4 prill është miratuar Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë gjendjes të jashtëzakonshme. Edhe krahas asaj se ky ligj rregullon mbrojtjen institucionale, jashtëinstitucionale të personave me aftësi të kufizuara dhe ndihmën në para, megjithatë në Dekret nuk kishte dispozita për realizimin e pandërprerë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë. Në fakt, me këtë Dekret është rregulluar procedura për marrjen e ndihmës të garantuar minimale për ekonomitë familjare materialisht të pasiguruara për muajt prill dhe maj të vitit 2020.⁷¹ Në mënyrë shtesë, është dhënë shtesë në para me qëllim që të mbulohet një pjesë e shpenzimeve për konsum të energjisë elektrike në ekonomitë familjare në prill dhe maj të vitit 2020.⁷² Madje dhe me ndryshimet dhe plotësimet e këtij dekreti janë përmendur personat me aftësi të kufizuara dhe realizimi i të drejtave të tyre për kompenzim në para. Këto ndryshime do të shqyrtohen më detajisht më poshtë në tekst.

Qeveria e RMV	3 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.89 e datës 3.4.2020
Qeveria e RMV	24 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë gjendjes të jashtëzakonshme</i>	“Gazeta zyrtare e RMV” nr.198 e datës 24.4.2020

⁷¹ Neni 2 i Dekretit.

⁷² Neni 3 i Dekretit.

MBROJTJA SHËNDETËSORE

Mbrojtja shëndetësore dhe sigurimi shëndetësor gjatë pandemisë për të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, mes të tjerash, ishin rregulluar edhe me Dekretin për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore dhe Dekretin për zbatimin e Ligjit për sigurim shëndetësor, si dhe dekretet për ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Dekretet e miratuar në këtë fushë kanë përfshirë çështjet që i referohen mbrojtjes të popullsisë nga sëmundjet ngjyhtëse, funksionimit të institucioneve shëndetësore, e drejta në sigurim shëndetësor, qasja në ilaçe dhe mjete tjera terapeutike.⁷³ Është karakteristike ajo se gjatë kohëzgjatjes të pandemisë, mbajtja e mbrojtjes personale për parandalimin e përhapjes të virusit korona ishte rregulluar me dekret përkatës dhe dy dekrete për ndryshimet dhe plotësimet e tyre. Këto dekrete nuk kanë përfshirë rethanat specifike të jetës të përditshme të personave me aftësi të kufizuara, për shembull problemet gjatë përdorimit të masës mbrojtëse, mjegullimin e syzeve, problemet me frymëmarrjen, pamundësia për lexim nga goja, si dhe problemet që paraqiten gjatë shpjegimit të nevojës për mbajtjen e maskës të disa personave me aftësi të kufizuara. Asnjë nga dekretet e theksuara më parë nuk përmend shprehimisht personat me aftësi të kufizuara.

Qeveria e RMV	24 mars 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 76 e datës 24.3.2020
Qeveria e RMV	6 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 92 e datës 6.4.2020

⁷³ Haxhi-Zafirov, ZH. (17 nëntor, 2020). *Analiza e dekretëve të miratuara me fuqi ligjore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme në vitin 2020. Grupi bluprint për reforma në gjyqësor. E disponueshme në: <http://blueprint.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/Анализа-на-донесение-уредби-со-законска-сила-за-време-на-вонредната-состојба-во-2020-Блупринт.pdf>.*

38 | Ndikimi i krizës të shkaktuar nga KOVID -19
mbi personat me aftësi të kufizuara
në Maqedoninë e Veriut

Qeveria e RMV	22 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për mbajtjen e mbrojtjes personale të personit për shkak të parandalimit të përhapjes, çrënjosjes të sëmundjes ngjyjtëse të shkaktuar nga virusi korona KOVID -19 dhe mbrojtja e popullsisë gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 107 e datës 22.4.2020
Qeveria e RMV	30 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 84 e datës 30.3.2020
Qeveria e RMV	30 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 100 e datës 13.4.2020

Qeveria e RMV	7 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për mbajtjen e mbrojtjes personale të personit për shkak të parandalimit, përhapjes dhe çrrënjësjes të sëmundjes ngjitëse të shkaktuar nga virusi korona KOVID-19 dhe mbrojtje të popullsisë gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 118 e datës 7.5.2020
Qeveria e RMV	15 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për mbajtjen e mbrojtjes personale të personit për shkak të parandalimit të përhapjes, çrrënjësjes të sëmundes ngjitëse të shkaktuar nga virusi korona KOVID-19 dhe mbrojtje të popullsisë gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme.</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 125 e datës 15.5.2020
Qeveria e RMV	29 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për sigurim shëndetësor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 140 e datës 29.5.2020

Qeveria e RMV	29 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 140 e datës 29.5.2020
Qeveria e RMV	12 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për sigurim shëndetësor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 156 e datës 12.6.2020
Qeveria e RMV	12 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 156 e datës 12.6.2020
Qeveria e RMV	22 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 169 e datës 22.6.2020

TREGU I PUNËS

Gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme janë miratuar një numër i konsideruar i dekreteve që kanë rregulluar gjendjen me tregun e punës. Një pjesë e tyre i referohet marrëdhënieve të punës dhe të drejtave të punëtorëve, ndihmës shtetërore financiare për kompanive të goditura me qëllim të subvencionimit të rrogave dhe subvencionimit të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social, si dhe ndihmë shtetërore financiare dhe mbështetje për personat në rrezik social. Edhe pse këto çështje prekin drejtëpërdrejtë personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, përmes këtyre personave që kujdesen për to, megjithatë ata ishin lënë pas dore nga teksti i dispozitave për subvencionimin e rrogave dhe kontributeve për punëtorët. Përveç asaj, as dekretet për mbështetje financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, persona të rinj dhe punëtorë shëndetësor përmes krijimit të kartës vendore pagesore të dedikuar për blerjen e produkteve maqedonase dhe shërbimeve gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme nuk kanë përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Qeveria e RMV	4 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 90 e datës 4.4.2020
Qeveria e RMV	6 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për subvencionimin e pagesës të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 92 e datës 6.4.2020

42 | Ndikimi i krizës të shkaktuar nga KOVID -19
mbi personat me aftësi të kufizuara
në Maqedoninë e Veriut

Qeveria e RMV	7 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të punëdhënësve nga sektori privat të goditur nga kriza shëndetësore- ekonomike të shkaktuar nga virusi KOVID-19, për shkak të pagesës të rrogave për prill dhe maj të vitit 2020</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 93 e datës 7.4.2020
Qeveria e RMV	9 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësve nga sektori privat të goditur nga kriza shëndetësore-ekonomike të shkaktuar nga virusi KOVID-19, për shkak të pagesës të rrogave për prill dhe maj të vitit 2020</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 97 e datës 9.4.2020
Qeveria e RMV	28 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të punëdhënësve nga sektori privat të goditur nga kriza shëndetësore-ekonomike të shkaktuar nga virusi KOVID -19, për shkak të pagesës të rrogave për prill dhe maj të vitit 2020</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 111 e datës 28.4.2020

Qeveria e RMV	1 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësve nga sektori privat të goditur nga kriza shëndetësore-ekonomike të shkaktuar nga virusi KOVID-19, për shkak të pagesës të rrogave për prill dhe maj të vitit 2020</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 113 e datës 1.5.2020
Qeveria e RMV	1 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 113 e datës 1.5.2020
Qeveria e RMV	5 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për subvencionin e pagesës të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 116 e datës 5.5.2020
Qeveria e RMV	27 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë gjatë kohës të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 136 e datës 27.5.2020

44 | Ndikimi i krizës të shkaktuar nga KOVID -19
mbi personat me aftësi të kufizuara
në Maqedoninë e Veriut

Qeveria e RMV	27 maj 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, persona të rinj dhe punëtorë shëndetësor përmes lëshimit të kartës pagesore vendore të dedikuara për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase gjatë kohës të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 137 e datës 27.5.2020
Qeveria e RMV	3 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, personave të rinj dhe punëtorëve shëndetësor përmes lëshimit të kartës pagesore vendore të dedikuar për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 146 e datës 3.6.2020

Qeveria e RMV	6 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësve nga sektori privat të goditur nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga virusi KOVID-19, për shkak të pagesës të rrogave për muajt prill dhe maj të vitit 2020</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 154 e datës 10.6.2020
Qeveria e RMV	12 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, personat e rinj dhe punëtorët shëndetësor përmes lëshimit të kartës pagesore të dedikuar për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 156 e datës 12.6.2020

46 | Ndikimi i krizës të shkaktuar nga KOVID -19
mbi personat me aftësi të kufizuara
në Maqedoninë e Veriut

Qeveria e RMV	13 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetje financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, persona të rinj dhe punëtorë shëndetësor përmes lëshimit të kartës pagesore vendore të dedikuar për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 157 e datës 13.6.2020
Qeveria e RMV	22 qershor 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të qytetarëve dhe personave të punësuar me të ardhura të ulëta, persona të rinj dhe punëtorë shëndetësor përmes lëshimit të kartës pagesore vendore të dedikuar për blerjen e produkteve dhe shërbimeve maqedonase gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 169 e datës 22.6.2020

1.2.1.2. Dekretet teksti i të cilave shprehimisht përmend personat me aftësi të kufizuara

Qeveria e RMV	7 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e dispozitave nga Ligji për punësim të personave invalidor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 94 e vitit 7.4.2020
Qeveria e RMV	24 prill 2020	<i>Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe zbatimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme</i>	„Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 108 e datës 24.4.2020

Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e dispozitave nga Ligji për punësimin e personave invalidor gjatë gjendjes të jashtëzakonshme

Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e dispozitave nga Ligji për punësimin e personave invalidor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme⁷⁴ kishte për qëllim që të përcaktojë dhe të vazhdojë afatet për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve në pajtim me Ligjin për punësimin e personave invalidor gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme dhe vazhdojnë pas skadimit respektivisht kalimit të kohës për të cilën është shpallur gjendja e jashtëzakonshme, por vetëm për aq ditë sa kanë mbetur.

Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë gjendjes të jashtëzakonshme

⁷⁴ Qeveria e RMV.

Me Dekretin me fuqi ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme për herë të parë shprehishmisht është përmendur e drejta nga mbrojtja sociale që realizojnë personat me aftësi të kufizuara. Dekreti ka vazhduar realizimin e të drejtës në kompenzim për shkak të aftësisë të kufizuar gjatë kohëzgjatjes të gjendjes të jashtëzakonshme, si dhe për dy muaj pas pushimit të gjendjes të jashtëzakonshme. Nevojitej që e drejta e kompenzimit për shkak të aftësisë të kufizuar të realizohet në bazë të mendimit konziliar nga komisioni i shkallës të parë të përbërë nga tre mjek specialist të entit përkatës shëndetësorë terciar, me çfarë është rekomanduar kontroll në periudhën e kohëzgjatjes të gjendjes të jashtëzakonshme.

2. TË DHËNA NGA ANALIZA E PYETËSORËVE ME AKTORËT RELEVANT

Pyetëtori që ishte dërguar në 10 institucione dhe 15 organizata që punojnë në fushën e mbrojtjes të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të grumbullimit të informatave, i referohej masave dhe politikave që ishin miratuar në fillim të pandemisë, dhe deri më sot, duke përfshirë këtu edhe masat që ishin miratuar gjatë kohës të gjendjes të jashtëzakonshme. Kjo pjesë shqyrton në mënyrë të ndarë përgjigjet e fituara nga institucionet dhe përgjigjet e fituara nga organizatat.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR AKTORËT E ANKETUAR

Përgjigje në pyetësor të dedikuar për institucionet shtetërore është dorëzuar vetëm nga një ministri – Ministria e arsimit dhe shkencës. Pyetëtori nuk i është përgjigjur Ministria e punëve të brendshme,⁷⁵ Ministria e drejtësisë, Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e shëndetësisë, Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut, Trupi nacional koordinues për zbatimin e KDPAK, Enti për veprimtari sociale, Avokati i popullit, Byroja për zhvillim të arsimit.

Pyetëtorit të dedikuar për organizatat i janë përgjigjur gjithsej tetë aktor relevant, dhe atë, pesë shoqata vendore të qytetarëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përfaqësojnë interesat e tyre përmes punës të drejtëpërdrejtë me ta, një organizatë ndërkombëtare dhe dy njësi organizative të Fakultetit filozofik pranë Universitetit “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup–Instituti për edukim special dhe rehabilitim dhe Instituti për punë sociale dhe politikë sociale.

⁷⁵ Ministria e punëve të brendshme ka dorëzuar përgjigjet në pyetësor pas përfundimit të përpunimit të të dhënave të paraqitura në këtë analizë. Përgjigjet e dorëzuara ishin të pamjaftueshme dhe nuk kanë përfshirë problemin që është lëndë e këtij hulumtimi, dhe rrjedhimisht përgjigjet nuk ishin marrë parasysh në gjetjet e paraqitura.

2.1. Institucionet

Ministria e arsimit dhe shkencës përmes drejtorive dhe shërbimeve profesionale të shkollave shtetërore për nxënës me nevoja të veçanta arsimore ka marrë pjesë në miratimin e masave për përballje me pandeminë në fushën e arsimit, si dhe në përgatitjen e planit dhe protokollit për realizimin e mësimdhënies.

Ministria e arsimit dhe shkencës konsideron se nevojat e personave me aftësi të kufizuara janë reflektuar në masa, duke patur parasysh se Komisioni për sëmundje ngjitëse ka propozuar në shkolla të mesme profesionale me numër më të vogël të nxënësve, që mësimdhënia të realizohet me pjesëmarrjen e tyre fizike. Megjithatë, pas vlerësimi të bërë të rrezikut në lidhje me mundësinë e kufizuar për të praktikuarit e masave parandaluese, organizimi i transportit grupor për nxënësit e mjediseve të ndryshme dhe akomodimi në konvikt dhe grupimi, për dy shkolla të mesme Komisioni nuk ka rekomanduar mësimdhënie me prani fizike. Në përgjigjen e tij nëse nevojat e personave me aftësi të kufizuara janë marrë parasysh gjatë përgatitjes të masave, Ministria nuk shqyrtoi nevojat tjera të cilat i kanë nxënësit e përfshirë në procesin arsimor. Për shembull,

Ministria për arsim nuk ka shqyrtuar mësimin në distancë dhe si ai do pasqyrohet mbi fëmijët me aftësi të kufizuara, edhe pse kjo ishte pengesa kryesore e drejtuar nga të anketuarit tjerë

në këtë pjesë, nuk është shqyrtuar mësimdhënia në distancë dhe si ajo pasqyrohet mbi fëmijët me nevoja të veçanta, edhe pse kjo është pengesa kryesore e theksuar nga të anketuarit tjerë.⁷⁶ Ministria thjesht thekson se mësimi onlajn nuk është përkatës për nxënësit me aftësi të kufizuara (pengesa) intelektuale, si përfundim te i cili kanë ardhur organet udhëheqës në shkollat e mesme profesionale. Në pyetjen për efektet pozitive dhe negative që i kanë patur masat mbi përditshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, Ministria konsideron se është e evidente se këto nxënës që janë në mësim me prani fizike kanë sukses më të madh në mbizotërimin e materialit të dhënë, për dallim nga ato nxënës me aftësi të kufizuara që ndjekin mësim onlajn.⁷⁷

⁷⁶ Për më shumë shihni fq. 14-15.

⁷⁷ Në pyetësor është përgjigjur Ministria e arsimit dhe shkencës.

Mekanizmi përmes të cilit Ministria ndjek se çfarë efekte kanë patur masat e miratuara mbi personat me aftësi të kufizuara dhe realizimin e të drejtave të tyre në kontaktin e përditshëm me drejtorët dhe shërbimet profesionale në shkolla. Rrjedhimisht, shtrohet pyetja nëse ky është mekanizmi përkatës për ndjekjen e efekteve nga masat, respektivisht nëse Ministria në këtë mënyrë do të marrë informatat e nevojshme mbi bazë të së cilave do të mundet më vonë të ndryshojë masat ekzistuese apo të formulojë masat e reja.

Në pyetjen nëse gjendja me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është përkeqësuar gjatë kohës të pandemisë dhe cilat ka qënë pengesa/t më e madhe/të mëdha me të cilat janë përballur personat me aftësi të kufizuara gjatë kohës të pandemisë, Ministria ka thënë se „nxënësve me aftësi të kufizuara u janë mundësuar kushtet e njëjta për mësim si edhe nxënësve tjerë”⁷⁸. Megjithatë, me këtë pretendim Ministria hapur tregon se nuk i merr parasysh nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme të nxënësve, respektivisht, se jo gjithmonë kushtet e njëjta për arsim janë përkatëse për të gjithë nxënësit. Trajtimi i ndryshëm ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara me qëllim që ata të kenë mundësi të njëjta për mësim si të tjerët nuk paraqet pabarazi. Drejtësia në këtë kuptim nënkupton përshtatjen e arsimit dhe mësimin në mënyrë proporcionale me rethanat në të cilat në përditshmëri funksionojnë personat me aftësi të kufizuara.

2.2. Organizatat

Kjo pjesë analizon të dhënat e marra nga përgjigjet e pesë shoqatave qytetare vendore që veprojnë në fushën e mbrojtjes të personave me aftësi të kufizuara dhe përfaqësojnë interesat e tyre përmes punës të drejtëpërdrejtë për to, një organizatë ndërkombëtare dhe dy njësi organizative të Fakultetit Filozofik pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup – Instituti për edukim special dhe rehabilitim dhe Instituti për punë sociale dhe politikë sociale.

78 Po aty.

PËRFSHIRJA E ORGANIZATAVE DHE INSTITUCIONEVE NË PROCESIN E MIRATIMIT TË MASAVE

Pesë shoqatat qytetare vendore që drejtëpërdrejtë punojnë me personat me aftësi të kufizuara janë përgjigjur se aspak nuk janë përfshirë në procesin e përgatitjes dhe miratimit të masave për përballje me pandeminë. Vetëm një nga këto pesë shoqata (20 përqind) është përgjigjur se propozimet e tyre ka dorëzuar pasi që janë miratuar masat e para për parandalim dhe mbrojtje. Janë pranuar kërkesat e tyre që i janë referuar ndryshimeve në regjimin e lëvizjes gjatë kohës të orës policore, të liritimit të personave me aftësi të kufizuara nga aktivitetet e punës dhe në vazhdimin e rëndësisë të mendimeve konziliare për furnizimin e ilaçeve. Shoqatat nuk kanë informatë nëse ndonjë shoqatë është përfshirë në procesin e miratimit të masave dhe rekomandimeve, as se në çfarë mënyrë janë dorëzuar dhe nëse janë pranuar propozimet e tyre.

Një organizatë ndërkombëtare është përgjigjur se ka propozuar masën për garantimin e sigurisë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla, pa arsyetuar në ndërkohë nëse propozimi është pranuar dhe nëse ky propozim është dhënë para apo pas miratimit të masave tjera në fushën e arsimit.

Kjo do të thotë se, në përgjithësi, në procesin e përgatitjes dhe miratimit të masave që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë i referohen personave me aftësi të kufizuara nuk janë përfshirë shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë fushë. Shoqatat kanë reaguar me kërkesat e tyre, respektivisht kanë dorëzuar propozime për ndryshime të masave pas miratimit të tyre nga ana e Qeverisë, dhe me këtë në mënyrë të konsideruar është zvogëluar të përballurit efektiv me krizën dhe implikimet e saj negative për personat me aftësi të kufizuara. Për shkak të mospërfshirjes të shoqatave në miratimin e vendimeve, kërkesat e tyre nuk ishin pasqyruar në masa. Duke mos respektuar detyrimin e paraparë me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, shteti nuk ka mundur bashkëpunimin e koordinuar me të gjithë aktorët relevant, konkretisht me shoqatat përfaqësuese të qytetarëve. Kjo padyshim se ka

kontribuar në mosbashkëpunim, moskoordinim dhe mosinformim ndërmjet vetë shoqatave.

Ekspertët e caktuar dhe përfaqësuesit nga dy institucionet arsimore pranë Fakultetit filozofik ishin përfshirë në miratimin e masave, por ata nuk kanë përfaqësuar qëndrimet e instituteve. Janë marrë parasysh propozimet e tyre në fushën e mbrojtjes sociale.

PËRFSHIRJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË MASA DHE PASQYRIMI PËRKATËS I NEVOJAVE TË TYRE

Shoqatat qytetare vendore konsiderojnë se personat me aftësi të kufizuar në asnjë mënyrë nuk kanë qënë të përfshirë në procesin e miratimit të masave, dhe rrjedhimisht, edhe ata nuk janë përgjigjur në mënyrë përkatëse në nevojat e tyre. Nga gjithsej tetë aktorë, dy nuk janë përgjigjur në pyetjen *Nëse personat me aftësi të kufizuara ishin (mjaftueshëm) apo në mënyrë përkatëse të përfshirë në miratimin e masave gjatë kohës të pandemisë?* Të gjithë pesë shoqatat qytetare konsiderojnë se masat nuk kanë marrë parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara, as, që, janë të përfaqësuara në mënyrë përkatëse interesat e tyre. Sipas një shoqate, papërshtatshmëria e masave është për shkak se shteti më parë nuk kishte bërë as statistikë, as evidencë të personave me hendikep (...) infrastruktura ekzistuese dhe korniza legjislative nuk janë harmonizuar me KDPAK.⁷⁹

Si masë ekzistuese pozitive, shoqatat theksojnë lehtësimin e lëvizjes të personave me aftësi të kufizuara gjatë kohës të orës policore me shoqërues, pa leje të veçantë për lëvizje. Sipas shoqatave, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar është pasqyruar negativisht në shfuqizimin e transportit të organizuar, mbështetjes jo të përshtatur për ndjekjen e mësimdhënies

⁷⁹ Pyetësori i përgjigjur nga Polio Plus.

arsimore, pranimit të kufizuar në qendrat ditore dhe kopshtet ditore, pranimi i reduktuar në institucionet për rehabilitim, sidomos për fëmijët në zhvillim. Shoqatat vendore dhe organizatat vendore janë pajtuar se pandemia dhe masat kufizuese për lëvizje janë pasqyruar negativisht në nevojat për aktivitet fizik dhe aktivitete në natyrë të fëmijëve me nevoja të veçanta.

**Shteti më parë
nuk kishte bërë
as statistikë,
as evidencë të
personave me
hendikep (...) insfrastruktura
ekzistuese
dhe korniza
legjislative
nuk janë
harmonizuar me
KDKPAK**

Në pyetjet *Nëse (...) gjendja me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është përkëqësuar gjatë kohës të pandemisë? A janë vështirësitë me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara më të shprehura në këtë periudhë? Nëse po, pse, çfarë ka sjellur këtë rezultat?* Katër nga gjithsej tetë aktorë janë përgjigjur se pozita e personave me aftësi të kufizuara është përkëqësuar në mënyrë të konsideruar si rezultat i pandemisë, një organizatë është përgjigjur se pozita e tyre nuk është përkëqësuar, kurse një organizatë nuk është përgjigjur në këtë pyetje. Shoqatat konsiderojnë se pengesat të cilat edhe para pandemisë kanë ekzistuar për personat me aftësi të kufizuara, kanë dalur në sipërfaqe dhe ishin theksuar në mënyrë shtesë në periudhën e kaluar. Në fakt, masat e miratuara kanë ndikuar negativisht mbi socializimin e tyre, frika dhe rreziku i rritur për

sëmundje, duke marrë parasysh se në përditshmërinë e personave me aftësi të kufizuara janë përfshirë një numër i madh i aktorëve (ndihmës personal, ndihmës arsimor, përkujdesës etj.) Një pjesë a madhe e shërbimeve ishin ndërprerë, kurse rekomandimi për distancë fizike ka vështirësuar marrjen e mbështetjes individuale. Në të njëjtën kohë, një goditje e konsideruar për personat me aftësi të kufizuar ishte ajo se në këtë periudhë nuk ishin përgatitur procedura të specializuara që detajisht përpunojnë se si në mënyrë të sigurtë të përdorin shërbimet në shtëpi.

ARSIMI

Shtatë nga tetë aktorët e anketuar theksojnë se pengesa më serioze me të cilën janë përballur fëmijët me aftësi të kufizuara në procesin arsimor është mësimitdhënia e papërshtatshme onlajn.⁸⁰ Sipas mendimit të tyre, mësimitdhënia nuk është përshtatur për personat me llojë të ndryshme të aftësive të kufizuara. Një shembull për këtë është se mësimitdhënia realizohej në Shërbimin televiziv nacional, Radio televizioni maqedonas nuk ka trajtuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara sensorike për shkak se nuk është siguruar interpretues të gjuhës të shenjave. Një nga aktorët thekson se pengesat për personat me aftësi të kufizuara në procesin arsimor në masë të madhe rrjedhin nga ajo se ata nuk kanë qasje në teknologjinë përkatëse ndihmëse, kurse për një pjesë të fëmijëve problemin e lokalizon në mungesë të qasjes individuale gjatë realizimit të planit të tyre individual, që nënkuptonte se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë marrë ndihmë nga shërbimi profesional. Sipas mendimit të aktorit tjetër, mungesa e teknologjisë ndihmëse është rezultat i asaj që prindërit nuk kanë mjete të mjaftueshme që ta sigurojnë në kushte vendore, kurse ajo në fund sjell deri te lënia pas dore e komponentës rehabilituese të arsimit. Më tutje, aktori thekson se efektet negative nga mësimitdhënia e papërshtatur mund të zbuten nëse shteti vendos në funksion kapacitetet njerëzore përmes sigurimit të punësimeve të përkohshme për edukatorët e papunë special dhe rehabilituesit dhe kuadrin mësimor për mbështetje të fëmijëve për mësim nga shtëpia.

Është simptomatik fakti se Ministria e arsimit dhe shkencës në përgjigjen e saj në pyetjen nëse nevojat e personave me aftësi të kufizuara janë marrë parasysh gjatë përgatitjes dhe miratimit të masave aspak nuk shqyrton sfidat që mësimi onlajn ka vendosur për fëmijët. Një pjesë e këtyre sfidave i referohen mospasjes të platformës përkatëse për arsim onlajn, kurse kjo pamundëson realizimin e planeve individuale mësimore; mospërshtatje të mësimitdhënies

⁸⁰ Një i anketuar është përgjigjur se personat me aftësi të kufizuara janë përballur me vështirësi në të gjithë fushat, pa arsyetim për pengesat në secilën fushë ndaras.

onlajn ndaj personave me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara; mungesës të teknologjisë ndihmëse; dhe mungesës të edukatorëve special dhe rehabilituesve social dhe kuadrit mësimor për mbështetjen e fëmijëve për ndjekjen e mësimin nga shtëpia. Kjo në mënyrë shtesë tregon në atë se shteti ka dështuar në përmbushjen të edhe një detyrimi të tij në pajtim me Konvetën, e kjo është respektimi i të drejtës për mbrojtje të domosdoshme dhe ndihmë nga shoqëria dhe shteti për të gëzuarit e plotë dhe të barabartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

SHËNDETËSIA

Gjashtë nga tetë aktorë pajtohen se qasja në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre është shprehur në mënyrë më të kufizuar gjatë kohës të pandemisë. Një pjesë e tyre (dy aktorë) theksojnë pritjen e rradhëve në farmaci dhe punën e tyre të reduktuar si një nga pengesat. Personat me aftësi të kufizuara në këtë periudhë janë përballur me padisponueshmëri në shërbimet për rehabilitim dhe zhvillim të hershëm, furnizim të mjeteve ndihmëse ortopedike dhe shërbimet tjera specialiste.

Një sfidë e konsideruar në periudhën e kaluar ka qënë furnizimi i terapisë me medikamente, të cilën shpesh familjen e furnizojnë vetë nga jashtë vendit. Ata janë përballur me vonesa apo pamundësi në furnizimin e ilaçeve të nevojshme. Përveç asaj, duke patur parasysh se institucionet shëndetësore ishin vendosur tërësisht në funksion të tejkalimit të pasojave nga pandemia, të gjithë kontrollat dhe intervenimet tjera rrjedhëse ishin shtyrë, duke kufizuar shërbimet të cilat institucionet shëndetësore i ofrojnë për personat me aftësi të kufizuara. Sipas aktorëve të anketuar, “kjo gjendje te shumë persona me aftësi të kufizuara ka sjellur deri te përkeqësimi i gjendjes shëndetësore, por edhe te shëndeti mendor”.⁸¹ Duke patur parasysh gjurmën që pandemia e ka lënë mbi shëndetin mendor të personave me aftësi të kufizuara, përmes UNICEF

81 Pyetësor i përgjigjur nga Instituti për edukim special dhe rehabilitim.

dhe ESHP Klinika universitare për psikiatri janë prezantuar linja telefonike për mbështetje psikosociale. Megjithatë, aktorët theksojnë se pengesat në modelin hyrës telefonik për mbështetje është ajo se informatat nuk janë të disponueshme për të gjithë personat me lloje të ndryshme të pengesave.

Pandemia ka imponuar edhe probleme të reja për personat me aftësi të kufizuara, kurse pasojat nga përballja jo përkatëse me krizën në mënyrë më të sigurtë ka prekur ato në raport me personat tjerë. Në fakt, sportelet për testim për virusin korona ishin të paqasshme dhe të padisponueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe informatat për mënyrën e realizimit të testimit në masë të madhe nuk u janë përcjellur në mënyrë përkatëse. Parimi i njëjtë ishte zbatuar edhe gjatë përgatitjes të procedurave për vaksinim, të cilat sërish nuk marrin parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Nga këtu rrjedh se shteti nuk ka përmbushur detyrimin e tij për përshtatjen përkatëse dhe rrejdhimisht nuk ka siguruar të gëzuarit dhe realizimin e të drejtave nga mbrojtja shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara në bazë të njëjtë me të tjerët. Pamundësimi i përshtatjes përkatëse paraqet diskriminim.⁸²

MBROJTJA SOCIALE

Në pyetjen nëse dhe me çfarë vështirësish janë përballur personat me aftësi të kufizuara në fushën e mbrojtjes sociale, aktorët janë përgjigjur se gjatë kohës të pandemisë në mënyrë të konsideruar u është vështirësuar grumbullimi dhe ripërtrirja e dokumenteve për realizimin e të drejtave të sigurimit social. Në mënyrë shtesë, shërbimet e pazhvilluara për mbështetje sidomos kanë goditur personat me aftësi të kufizuara që jetojnë vet apo me prindër/

**Shërbimet e
pazhvilluara për
mbështetje sidomos
kanë goditur
personat me aftësi
të kufizuara që
jetojnë vet apo me
prindër/kujdestar
më të moshuar**

82 Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut (30 tetor, 2020). *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*. „Gazeta zyrtare e RMV” nr. 258/2020.

kujdestar më të moshuar. Korniza e përkufizuar ngushtë për mbështetje sociale ka kontribuar që një numër i madh i personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mbështesin kushtet për mbështetje në para, kurse për shkak të krizës kanë mbetur pa të ardhura apo me të ardhura të kufizuara apo, kanë humbur punën, të përballen me rrezik të rritur social dhe me varfëri.

Këto pikëpamje të shoqatave të qytetarëve që kanë marrë pjesë në hulumtim vetëm e nxjerrin në sipërfaqe të vërtetën e ashpër se pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara jetojnë në kushte të varfërisë. Duke injoruar nevojën për kritika për përkushtim të vëmendjes të ndikimeve negative të varfërisë mbi personat me aftësitë e kufizuara, sidomos në kushtet e një prej krizave më të mëdha shëndetësore dhe ekonomike, shteti ka vepruar në kundërshtim me Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe parimet të cilat është detyruar që t'i respektojë.⁸³

TREGU I PUNËS

Kriza shëndetësore, respektivisht përballja jo në kohë dhe jo përkatëse me pasojat e saj pa dyshim se ka shkaktuar pasoja negative ekonomike. Kjo njëkohësisht nënkuptonte dhe goditje mbi ata që ndodhen në rradhët e para mbrojtëse – punëtorët. Numri i madh i largimit të punëtorëve, zvogëlimi dhe mospagimi i rrogave të tyre, lënia e punëtorëve pa sigurim shëndetësor gjatë kohës të krizës më të madhe shëndetësore të viteve të fundit janë vetëm pjesë e problemeve të cilat pandemisë i japin karakter të krizës të punëtorëve.⁸⁴ Vetëm nga marsi deri në qershor, 700 punëtorë që kanë mbetur pa punë e kanë paraqitur atë në Komitetin e Helsinkit për të drejtat e njeriut.⁸⁵ Agjencia

⁸³ Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Preambulla, paragrafi p.

⁸⁴ Petkovska, N. (30 nëntor, 2020). *Pasqyra e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona dhe ndikimi i tyre mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut.

⁸⁵ Ibid.

e punësimit numëron 43 086 persona që kanë mbetur pa punë pas fillimit të krizës në mars të vitit 2020.⁸⁶

Një nga shoqatat e anketuara thkeson se gjatë punës të tyre kanë regjistruar largime të personave me aftësi të kufizuara për shkak të vëllimit të zvogëluar të punës te punëdhënësit. Ata shtojnë se një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuara ishin përfshirë nga masat për lirim nga puna si punëtorë me gjendje kronike shëndetësore. Por, siç thekson tjetër aktor në pyetësin e përgjigjur, edhe krahas asaj se personat me aftësi të kufizuara, të liruar nga ushtrimi i detyrimeve të punës, ishin të mbrojtur nga largimi nga puna gjatë kohës të pandemisë, një pjesë më e madhe e tyre janë të punësuar në shoqatat mbrojtëse, të cilat për shkak të vëllimit të zvogëluar të punës dhe zëvendësimit të një pjesë të aktiviteteve prodhuese, mund të falimentojnë. Sipas mendimit të këtij aktori, “Komunitetit i shoqatave mbrojtëse të Maqedonisë pret një numër më të madh të shoqatave mbrojtëse që të falimentojnë deri në fund të vitit” dhe kjo do të thotë se personat me aftësi të kufizuara munden de facto të mbesin pa punë.

Edhe një problem që ka dalur nga analiza e përgjigjeve të shoqatës janë vështirësitë me angazhimin me punë me të cilin përballen personat me aftësi të kufizuara në mjediset rurale. Në fakt, personat që janë të angazhuar përkohësisht si punëtorë sezonal kanë frikë se nuk do të kenë punë të mjaftueshme për shkak të prodhimit të zvogëluar dhe eksportit të prodhimit jashtë vendit.

⁸⁶ Agjencia për punësim në qershor ka filluar që të zhvillojë statistikë të ndarë për të ardhurat e personave që kanë fituar statusin e personave të papunë, për të cilët çlajmërimi nga sigurimi i detyrueshëm social është regjistruar në periudhën pas 11.3.2020. Këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i personave të papunë, duke filluar nga marsi i vitit 2021. Numri i personave të papunë për mars, prill dhe maj, për të cilët APRM nuk ka mbajtur statistikë të ndarë në raport me krizën, është 21 838 persona. Agjencia e punësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021). *Pasqyra e të dhënave për hyrjet dhe daljet e personave të papunë*. E disponueshme në: <https://av.gov.mk/pregled-na-podatoci-za-priliv-i-odliv-na-nevraboteni-lica.nspix>.

LËVIZSHMËRIA DHE TRANSPORTI DHE QASJA NË INFORMATA

Pesë nga tetë aktorë të anketuar shprehimisht kanë theksuar se qasja në transport e personave me aftësi të kufizuara është kufizuar dhe vështirësuar në mënyrë shtesë gjatë kohës të pandemisë. Një prej palëve të përfshira si problem thekson mos qasshmërinë e transportit, kurse kjo në mënyrë shtesë ka rritur shpenzimet e transportit individual (për shembull, taksit). Për më tepër, transport publik të organizuar ka në Shkup dhe në qytetet më të mëdha në vend, kurse kjo do të thotë se në periudhën e kaluar ishte veçanërisht e vështirë për personat me aftësi të kufizuara nga mjediset rurale, ku personat janë lënë “të vetëm”.

Kjo vetëm aktivizon detyrimin e shtetit që të përkushtojë vëmendje të veçantë në atë se si ndikojnë rethanat e pandemisë mbi rritjen e rrezikut nga varfëria te personat me aftësi të kufizuara. Përshtatja jo përkatëse e transportit që është njësoj i disponueshëm për të gjithë personat edhe më shumë rrit dallimet ndërmjet personave me aftësi të kufizuara dhe qytetarëve tjerë, por edhe ndërmjet vet personave me aftësi të kufizuara. Kjo është vërtetuar në mënyrë shtesë edhe nga një aktor i anketuar, i cili dëshmon për atë se “numër i vogël i tyre [persona me aftësi të kufizuara] kanë qasje në automjete të përshtatura që do të shfrytëzohen në funksion të realizimit të detyrimeve të tyre të përditshme”.


3. TË DHËNA NGA ANALIZA E PYETËSORËVE ME PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PERSONA QË KUJDESEN PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Gjatë prezantimit të të dhënave nga pyetëtorët e përpunuar, gjetjet e fituara janë grupuar sipas disa fushave.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR TË ANKETUARIT


Me pyetëtorët e dedikuar për personat me aftësi të kufizuar dhe persona që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara ishin përfshirë gjithsej 219 të anketuar, prej të cilëve 27,1 % ishin persona me aftësi të kufizuara, kurse 72,9 % persona që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara (grafikoni nr.1).

Grafikoni nr. 1. Në çfarë cilësie e plotësoni pyetëtorin?




Sipas llojit të aftësisë të kufizuar, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë theksuar se kanë aftësi të kufizuara të kombinuara (38,2 %), respektivisht se kujdesen për person me këtë lloj të aftësive të kufizuara. 27,6 % kanë aftësi të kufizuara fizike, kurse 18,4 % kanë aftësi të kufizuara intelektuale (grafikoni nr. 2).

Grafikoni nr. 2. Çfarë lloji të aftësive të kufizuara keni ju apo personi për të cilin kujdeseni?




Në grafikoni nr.3 është paraqitur struktura gjinore e të anketuarve, prej të cilëve pjesa më e madhe janë të gjinisë femërore (68,8 %), kurse një e treta nga gjinia mashkullore (31,2 %).

Grafikoni nr. 3. Gjinia e të anketuarve/-ave




Sipas moshës të personave me aftësi të kufizuara, grupmoshë më e përfaqësuar janë personat e mitur, respektivisht personat deri në 17 vjet me përfaqësim prej 39 %. Më shumë se gjysma e personave me aftësi të kufizuara, më saktësisht 53,3 % janë të moshës deri në 26 vjet.

Grafikoni nr. 4. Moshë e personit me aftësi të kufizuara




Në raport me përkatësinë etnike, grupi i të anketuarve që ishin përfshirë me këtë anketë nuk ishte heterogjene, respektivisht një pjesë shumë e vogël e të anketuarve i takojnë përkatësisë etnike të ndryshme nga ajo maqedonase (grafikoni nr. 5). Madje 86,7 % nga të anketuarit janë të përkatësisë etnike maqedonase, kurse vetëm 6,9 % janë shqiptare.

Grafikoni nr. 5. Përkatësia etnike e të anketuarve-ave




Kur bëhet fjalë për statusin e punës, siç është paraqitur në grafikoni nr.6, më shumë se gjysma e të anketuarve janë të punësuar (57,5 %), 32 % janë papunë, ndërsa vetëm një pjesë e vogël kanë deklaruar se janë shfrytëzues të pensionit (7,3 %).

Grafikoni nr. 6. Status i punës i anketuarve-ave




Në raport me numrin e personave me aftësi të kufizuara që jetojnë në ekonomi familjare, pjesa më e madhe të anketuarve jetojnë në ekonomi familjare ku ka një person me aftësi të kufizuara, respektivisht 82,6 % e të anketuarve, 10,1 % në ekonomi familjare me dy persona me aftësi të kufizuara, kurse 7,3 % e ekonomive familjare jetojnë me më shumë se dy persona me aftësi të kufizuara.

Grafikoni nr. 7. Numri i personave me aftësi të kufizuara që jetojnë në ekonominë familjare




Nga të anketuarit, respektivisht nga personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë përgjigjur në pyetësor apo janë persona për të cilat kujdeset i anketuari, vetëm 33,5 % janë të përfshirë në procesin arsimor (grafikoni nr. 8), prej të cilëve pjesa më e madhe në arsimin fillor (69,9 %). Në arsimin e mesëm janë përfshirë 20,5 %, kurse më pak në arsimin e lartë me 9,6 % (grafikoni nr. 9).

Grafikoni nr. 8. A jeni të përfshirë ju (si person me aftësi të kufizuara) apo personi me aftësi të kufizuara për të cilin kujdeseni në procesin arsimor?




Grafikoni nr. 9. Shkalla e arsimit në të cilën jeni përfshirë




INFORMIMI DHE PËRFSHIRJA

Në pyetjen nëse mendojnë se kanë qënë mjaftueshëm të informuar për atë se si të mbrohen nga virusi KOVID -19, pothuajse 90 % e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht (grafikoni nr. 10), kurse diçka më pak respektivisht 78,4 % janë përgjigjur se ishin mjaftueshëm të informuar kur janë miratuar masat e reja, ligjet dhe të ngjajshme gjatë pandemisë (grafikoni nr. 11).

Grafikoni nr. 10. A mendoni se ishit/jeni mjaftueshëm të informuar për atë se si të mbroheni nga virusi KOVID-19?




Grafikoni nr. 11. A mendoni se ishit/jeni mjaftueshëm të informuar kur miratohen masa të reja, ligje dhe të ngjajshme gjatë kohës të pandemisë?




Pjesa më e madhe e të anketuarve janë informuar për të drejtat e tyre, por edhe për masat e reja përmes televizionit (75,2 %), përmes rrjeteve sociale (58,7 %) dhe përmes faqeve të ndryshme të internetit (49,1 %) (grafikoni nr. 12).

Grafikoni nr. 12. Si jeni informuar për të drejtat tuaja dhe masat që janë miratuar gjatë pandemisë (me mundësi për përzgjedhje të më shumë përgjigjeve)?



Sa i përket përfshirjes në procesin e miratimit të masave për parandalim nga virusi KOVID-19, madje 87,6% e të anketuarve janë përgjigjur negativisht. Përveç asaj, është e rëndësishme të theksohet se pjesa e madhe e atyre të anketuarve që kanë theksuar se janë përfshirë në këto procese, për përfshirje të tyre e konsiderojnë respektimin e masave të parandalimit dhe mbrojtjes nga virusi.


Grafikoni nr. 13. A ishit përfshirë në procesin e miratimit të masave për parandalim dhe mbrojtje nga virusi korona?



REALIZIMI I TË DREJTAVE


Për një pjesë të madhe të të anketuarve (79,8 %), masat e parandalimit dhe mbrojtjes nga virusi kanë imponuar vështirësi në funksionimin e tyre të përditshëm.

Grafikoni nr. 14. A ju kanë shkaktuar masat për parandalim dhe mbrojtje nga virusi vështirësi në funksionimin e përditshëm?




Vështirësitë me të cilat janë përballur të anketuarit gjatë kohës të pandemisë në masë më të madhe janë të lidhura me socializimin e kufizuar (21,5 %) dhe lëvizjen e kufizuar (20,9 %), kurse 18,3 % janë përballur me vështirësi të lindura me ndjekjen e masave të mbrojtjes, respektivisht me mbajtjen e distancës fizike, shmangien e grupeve, si dhe vështirësi gjatë mbajtjes të maskës. Nga të anketuarit, 8,4 % kanë theksuar se kanë patur vështirësi që kanë rrjedhur nga mosdisponueshmëria e shërbimeve për qëndrim ditor të fëmijëve, sidomos të mbylljes të qendrave ditore (grafikoni nr. 15).

Grafikoni nr. 15. Me cilat vështirësi jeni përballur gjatë pandemisë?




Gjysma e të anketuarve (52,3 %) janë përballur me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjatë kohës të pandemisë (grafikoni nr.16), prej të cilëve vetëm 38,6 % kanë deklaruar se janë drejtuar diku për ndihmë (grafikoni nr. 17) dhe vetëm një e treta prej tyre (36,8 %) kanë marrë ndihmën e kërkuar. Kërkesat e tyre për ndihmë të anketuarit më shpesh i kanë dërguar në qendrat për punë sociale 43,9 %, kurse 24,6 % deri te organizatat joqeveritare. Vetëm një pjesë e vogël, 8,8 % e të anketuarve janë drejtuar në polici.

Grafikoni nr. 16. A kishit vështirësi gjatë realizimit të të drejtave tuaja?




Grafikoni nr. 17. A jeni drejtuar diku për ndihmë?




SHËNDETËSIA

Marrja e shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtja shëndetësore gjatë kohës të pandemisë është realizuar me kufizime për 45,4 % nga të anketuarit (grafikoni nr. 18). Nga këto kufizime, 56,6 % i referoheshin shërbimeve të marra nga ana e specialistëve, 47,5 % për shërbimet e rehabilitimit, kurse 35,4% e shërbimeve nga mjeku amë. 28,3 % janë përballur me vështirësi në qasjen në ilaçe dhe në mjete ortopedike dhe mjete tjera ndihmëse (grafikoni nr. 19).

Grafikoni nr. 18. A jeni përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes shëndetësore gjatë pandemisë?




Grafikoni nr. 19. Vështirësitë gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes shëndetësore me të cilat jeni përballur (me mundësi për përzgjedhje të më shumë përgjigjeve)



Sipas mendimit të të anketuarve, ajo që do të kontribuonte për lehtësim të qasjes në shërbimet shëndetësore është profesionalizmi i punëtorëve shëndetësor (20,3 %), që përfshin edhe nevojën për komunikim më të mirë të punëtorëve shëndetësor me të anketuarit, si dhe sigurimi i qasshmërisë deri te shërbimet nga punëtorët shëndetësor, duke përfshirë mundësinë për vizitë fizike të mjekut (18,8 %). 13,1 % e të anketuarve konsiderojnë se është e nevojshme që personat me aftësi të kufizuara të kenë përparësi gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore, kurse 8,7 % kanë nevojë për numër përkatës të orareve për kontrolla dhe organizim më të mirë të shërbimeve (grafikoni nr. 20).


Grafikon nr. 20. Shënoni se çfarë do të lehtësonte qasjen tuaj në shërbime shëndetësore




MBROJTJA SOCIALE

Në pyetjen nëse jeni përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve nga mbrojtja sociale gjatë kohës të pandemisë, janë përgjigjur 28,9 % e të anketuarve. Pjesa më e madhe e vështirësive kanë rrjedhur nga mbyllja e qendrave ditore, në çfarë udhëzojnë 49,2 % e të punësuarve, 46 % kanë theksuar vështirësitë e lidhura me ndihmën kurse 44,4% qasja në shërbim (grafikoni nr. 22).

Grafikoni nr. 21. A jeni përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve të mbrojtjes sociale gjatë pandemisë?



Графикон бр. 22. Vështirësitë gjatë marrjes të shërbimeve të mbrojtjes sociale me të cilat jeni përballur (me mundësi për zgjedhje të më shumë përgjigjeve)




Në drejtim të përmirësimit të qasjes në shërbime të mbrojtjes sociale, të anketuarit konsiderojnë se është i nevojshëm profesionalizmi i të punësuarve, duke përfshirë edhe organizimin më të madh dhe funksionalitetin e administratës (28,9 %), si thjeshtësim të procedurave me parashtrimin dhe ripërtirjen e dokumentacionit për shfrytëzimin e dokumentacionit për shfrytëzimin e ndonjë të drejte të mbrojtjes sociale (23,7 %) (grafikoni nr. 23).

Edhe në periudhën para pandemisë një nga problemet më të shpeshta me të cilat janë përballur personat me aftësi të kufizuara ishte nevoja për të dëshmuar vazhdimisht aftësinë e kufizuar përmes ripërtirjes të dokumentacionit, dhe kjo ndonjëherë mund të kontribuojë të mbesin pa përfundimet e caktuara në periudhën e caktuar.⁸⁷ Disa nga të dhënat flasin edhe për atë se familjet përkujdesëse kanë më shumë përfitime se ato biologjike, para së gjithash, për shkak të kompenzimeve për përkujdesje të fëmijëve dhe/ose personave me aftësi të kufizuara, por edhe për shkak të se drejtës për ndihmë në para dhe të drejtës në pension.⁸⁸ Nga ana tjerë, prindërit shumë shpesh ndodh që të mos jenë në marrëdhënie punë me qëllim që të mund të kujdesen për personin me aftësi të kufizuara.

87 Kočovska, E., Shavreski, Z., Jovanova, B. Dhe Llazovski, V. (2017). *Analiza e gjendjes të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë*, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/>

88 *Infografik për aftësitë e kufizuara fizike*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/INFOGRAFIK_fizicka_poprecenost_04-01_3.pdf

Grafikoni nr. 23. Shënoni se çfarë do të lehtësonte qasjen në shërbime të mbrojtjes sociale




VENDI I PUNËS

Numri më i vogël i të anketuarve, respektivisht 29,4 % janë përballur me vështirësi në vendin e punës gjatë pandemisë, prej të cilëve pothuajse gjysma (48,4 %) ishin të lidhur me mungesë në vendin e punës për shkak të mbrojtjes nga virusi dhe për shkak të kujdesit për personin tjetër në shtëpi.


Sipas të dhënave nga analiza për “KOVID-19 dhe gjinia” një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuara kanë mbetur pa kompensime ekonomike për shkak të masave për mos shkuarje në punë, dhe me këtë drejtpërdrejtë janë të ekspozuar në varfëri dhe pa asnjë siguri sociale.⁸⁹ Duke patur parasysh se edhe para pandemisë personat me aftësi të kufizuara shumë shpesh janë përballur me vështirësi gjatë hyrjes në tregun e punës, tani ai rrezik është rritur në mënyrë të konsideruar, duke përfshirë edhe rrezikun e humbjes të vendit të punës, si dhe vështirësitë gjatë kthimit në vendin e punës.

⁸⁹ Qendra për hulumtim dhe krijimin e politikave (15 prill, 2020). *Kovid dhe gjinia (botimi i dytë)*. E disponueshme në: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/>.

Grafikoni nr. 24. A jeni përballur me vështirësi në vendin e punës gjatë pandemisë?



Grafikoni nr. 25. Vështirësi me të cilat jeni përballur në vendin e punës (me mundësi për zgjedhje të më shumë përgjigjeve)



ARSIMI


Duke marrë parasysh se vetëm një e treta e të anketuarve janë të përfshirë në arsim (faqe 22), madje 68,5 % prej tyre janë përballur me vështirësi në procesin arsimor (grafikoni nr.26). Pjesa më e madhe e vështirësive ishin të lidhura me platformën për mësim në distancë, e cila nuk është përgjigjur në nevojat e tyre, respektivisht në nevojat e personit për të cilat kujdesen (60 %), dhe me nevojën për mbështetje përkatëse për ndjekjen e mësimin, siç është, për shembull, ndihmësi mësimor, edukatori special dhe të ngjajshme (50 %). Pjesa më e vogël e të anketuarve nuk kanë patur pajisjen e nevojshme teknike për ndjekjen e mësimin (36 %) dhe përmbajtjet nga mësimi nuk ishin të qasshme (30 %) (grafikoni nr. 27). Edhe krahas përpjekjeve për promovimin e mësimin inkluziv dhe të drejtës të fëmijëve me aftësi të kufizuara që të jenë të përfshirë pandërprerë në të gjithë nivelet e procesit arsimor, sidomos me miratimin e Ligjit të ri për arsim fillor në vitin 2019, pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë të përfshirë në arsim ende përballen me diskriminim dhe vështirësi, dhe kjo sidomos është shprehur në fillim të pandemisë.⁹⁰ Këtë problem në arsimin fillor e kanë theksuar edhe numri i rritur i kërkesave për ndihmë juridike falas të drejtuara deri te Komiteti i Helsinikit për të drejtat e njeriut,⁹¹ por edhe deri te Avokati i popullit,⁹² të parashtruara nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara në lidhje me sigurimin e ndihmësit arsimor në vitin mësimor 2019/20, menjëherë pas miratimit të Ligjit të ri.

90 Komiteti i Helsinikit për të drejtat e njeriut (13 tetor, 2020). *Raporti i veçantë për gjendjen e të drejtave të njeriut gjatë Kovid -19*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshta%dl%98-za-sosto%dl%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>


91 Jovanovska, B. (2020). *Përforcimi juridik në komunitet në procesin e deinstitucionalizimit: raport*. Komiteti i Helsinikit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/finalen-izveshta%dl%98-uniczef-mk.pdf>

92 Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Mars, 2020). *Raport i veçantë nga hulumtimi i zbatuar për gjendjen me realizimin e të drejtës të arsimin të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. I disponueshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2020/Posebni%20izvestaj-Deca%20so%20poprecenost-2020.pdf>

Grafikon nr. 26. A jeni përballur me vështirësi në kuadër të procesit arsimor gjatë pandemisë?




Grafikoni nr. 27. Vështirësitë me të cilat jeni përballur në procesin arsimor (me mundësi për zgjedhje të më shumë përgjigjeve)



Me qëllim të tejkalimit të vështirësive me të cilat janë përballur në procesin arsimor, të anketuarit kanë theksuar se veçanërisht u është nevojitur mbështetje gjatë ndjekjes të mësimi nga ana e ndihmësit apo personit profesional (33,3 %). Nga 20% e të anketuarve kanë theksuar mësimin me prani

fizike dhe nevojën për pajisje më përkatëse dhe mjete ndihmëse për ndjekjen e mësimit, kurse 15,6 % kanë theksuar programin më të mirë për mësime të përshtatur në mënyrë përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Grafikoni nr. 28. Shënoni se çfarë do ju ndihmonte që të tejkaloni vështirësitë në procesin arsimor




TRANSPORTI DHE LËVIZSHMËRIA

Gjysma e të anketuarve (51,4 %) janë përballur me vështirësi të lidhura me transportin dhe lëvizshmërinë gjatë pandemisë (grafikoni nr. 29). Prej atyre që kanë patur vështirësi me transportin, pjesa më e madhe si problem kanë theksuar anulimin e transportit të organizuar nga qendrat ditore për personat me aftësi të kufizuara (28,3 %). 19,6 % e të anketuarve kanë patur vështirësi me transportin për shkak të transportit publik të kufizuar, respektivisht të reduktuar, duke përfshirë edhe autobusët dhe transportin me taksì, kurse 18,5 % kanë deklaruar se janë përballur me vështirësi gjatë shfrytëzimit të transportit publik për shkak të rrezikut nga virusi dhe pamundësia që të respektojnë masat për mbrojtje nga virusi (grafikoni nr. 30). Një pjesë e vështirësive të lidhura


82 | Ndikimi i krizës të shkaktuar nga KOVID -19 mbi personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut

me pamundësinë që të respektohen masat për mbrojtje nga virusi përbëhen nga problemet gjatë përdorimit të maskës mbrojtëse, mjegullimit të syzeve, probleme me frymëmarrjen, pamundësi për lexim nga goja, si dhe probleme që shkaktohen gjatë shpjegimit të nevojës për mbajtjen e ndonjërit prej personave me aftësi të kufizuara.

Grafikoni nr. 29. A jeni përballur me vështirësi në transport/lëvizshmëri gjatë pandemisë?




Grafikoni nr. 30. Vështirësitë me të cilat jeni përballur në raport me transportit/lëvizshmëri



Rrjedhimisht, në drejtim të tejkalimit të vështirësive me transportin, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se ajo që do u ndihmonte më së shumti është futja e sërishme e transportit të organizuar për përdoruesit e qendrave ditore (27,5 %), si dhe sigurimi i transportit të organizuar dhe special për personat me aftësi të kufizuara (26,1 %) (grafikoni nr. 31).


Grafikoni nr. 31. Shënoni se çfarë do ju ndihmonte që të tejkaloni problemet me transportin




SHPENZIMET

Për pjesën më të madhe të të anketuarve (76,1 %), pandemia ka kontribuar për rritjen e shpenzimeve (grafikon nr. 32). Nga shpenzimet, të cilat kanë paraqitur ngarkesë më të madhe për të anketuarit në këtë periudhë, në mënyrë konsideruar mbizotërojnë ata që janë të dedikuara për mjete higjienike, duke përfshirë edhe mjetet për mbrojtje nga virusi (82,5 %). Sa i përket llojeve tjera të shpenzimeve, më shumë se gjysma e të anketuarve, respektivisht 66,9 % janë përballur me shpenzime të rritura për ilaçe, dhe më pak, respektivisht 56,6 % për ushqim. Më pak se gjysma e të anketuarve kanë patur shpenzime të rritura për transport (41,6 %) dhe për strehim (39,8 %) (grafikoni nr. 33).

Grafikoni nr. 32. A ka kontribuar pandemia për rritjen e shpenzimeve tuaja të përditshme?




Grafikoni nr. 33. Cilët shpenzime ishin rritur si rezultat i pandemisë (me mundësi për zgjedhje të më shumë përgjigjeve)?



Pjesa më e madhe e të anketuarve (55,4 %) kanë deklaruar se ende nuk kanë patur sukses që të tejkalojnë problemet me shpenzimet me të cilat janë përballur këtë periudhë (grafikon nr. 34).


Grafikoni br. 34. A keni patur sukses në tejkalimin e problemeve me shpenzimet?



MASAT GJATË PANDEMISË


Në lidhje me përshtatshmërinë e masave të miratuara, sipas mendimit të më shumë të anketuarve (59,2 %), masat nuk u janë përgjigjur personave me aftësi të kufizuara, para së gjithash, për shkak të mospërfshirjes të tyre në miratimin, respektivisht mosmarrjen parasysh të nevojave të tyre specifike.

Grafikoni nr. 35. A mendoni se masat ishin përkatëse me nevojat e personave me aftësi të kufizuara?




Në pyetjen nëse keni shfrytëzuar ndonjë nga masat e Qeverisë të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara gjatë kohës të pandemisë, më shumë se dy të tretat (70,6 %) e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë shfrytëzuar asnjë masë (grafikoni nr. 36). Nga të anketuarit që kanë shfrytëzuar ndonjë prej masave, numri më i madh kanë shfrytëzuar masën për lirim nga puna më shpesh për kujdes për personin me aftësi të kufizuara (39,5 %), pastaj për lëvizjen e lirë gjatë kohës të orës policore (30,2 %) dhe numër më të vogël për ndihmë në para (14 %).

Grafikoni nr. 36. A keni shfrytëzuar ndonjë nga masat e Qeverisë të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë?




Grafikoni nr. 37. Cilat masa i keni shfrytëzuar?



Sa i përket llojit të mbështetjes që do të ishte më e dobishme, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë theksuar nevojën për ndihmën dhe mbështetjen financiare, madje 79,4 %. Nga të anketuarit, 39 % kanë theksuar nevojën për ndihmë dhe mbështetje në shtëpi, 31,2 % ndihmë dhe mbështetje gjatë vizitës të institucioneve, 28,4 % gjatë prokurimit të ilaçeve dhe 27,5 % gjatë furnizimit të ushqimeve (grafikoni nr. 38).

Grafikoni nr. 38. Çfarë lloj të ndihmës/mbështetjes mendoni se do të ishte më e dobishme gjatë pandemisë?





PËRFUNDIME

DHE REKOMANDIME



Shteti nuk ka respektuar detyrimet që për të rrjedhin nga Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, sidomos atyre në raporte me përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese në proceset e marrjes të vendimeve për politikat dhe programet; njohjen e rëndësisë të qasshmërisë deri te mjedisi fizik, social, ekonomik dhe kulturor, deri te shëndetësia dhe arsimi dhe informatat dhe komunikimet; ndërmarrjen e masave përkatëse që të identifikohen dhe të eliminohen pengesat në qasshmëri; si dhe ndërmarrja e të gjithë masave të nevojshme (në pajtim me detyrimet tjera ndërkombëtare-juridike) për mbrojtjen dhe sigurinë e personave me aftësi të kufizuara në situata të rrezikut, duke përfshirë edhe gjendjet e jashtëzakonshme.

ZBATIMI I VAZHUESHËM I KONVENTËS PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE RESPEKTIMI I TË GJITHË DETYRIMEVE QË AJO PARASHEH PËR SHTETIN, SIDOMOS DUKE MARRË PARASYSH KONTEKSTIN E PANDEMISË TË RE QË ËSHTË ENDE E PRANISHME.

PËRFSHIRJE NË PROCESET E MIRATIMIT TË MASAVE

Në procesin e përgatitjes dhe miratimit të masave që në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë i referohen personave me aftësi të kufizuara nuk ishin përfshirë shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë fushë. Shoqatat kanë reaguar me kërkesat e tyre, respektivisht kanë parashtruar kërkesa për ndryshimin e masave pas miratimit të tyre nga ana e Qeverisë. Në nivel individual, shoqatat që punojnë në këtë fushë nuk kanë informacion nëse ndonjë nga shoqatat tjera është përfshirë në procesin e miratimit të masave. Shoqatat që punojnë në këtë fushë nuk kanë bashkëpunuar mjaftueshëm ndërmjet veti, dhe kjo në masë të madhe ishte për shkak se shteti nuk ka mundësuar bashkëpunim të koordinuar me të gjithë aktorët relevant.

Personat me aftësi të kufizuara aspak nuk ishin përfshirë në miratimin e masave që i preknin ato. Rrjedhimisht, masat e miratuara nuk ishin në pajtim me nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që kujdesen për to. Vetëm një pjesë e vogël e masave kishin ndikim pozitiv mbi jetën e përditshme të personave me aftësi të kufizuara, por vetëm pas disa intervenimeve dhe kërkesave nga ana e shoqatave që punojnë në këtë fushë. Masat e vetme pozitive që ishin miratuar gjatë kohës të pandemisë janë referuar: mundësimi të lëvizjes të pandërprerë të personave me aftësi të kufizuara gjatë kohës të orës policore (është vepruar pas miratimit të kësaj mase). Megjithatë, lëvizja e kufizuar në masë të madhe është pasqyruar negativisht në nevojat për aktivitet fizik dhe aktivitet në natyrë për personat me aftësi të kufizuara. Masat e miratuara kanë injoruar nevojat që janë specifike për personat me aftësi të kufizuara në mjediset rurale. Shteti nuk mban statistikë as evidencë për personat me aftësi të kufizuara, dhe kjo nënkupton se nuk ka informata përkatëse për llojet e aftësive të kufizuara të këtij grupi të qytetarëve, që, kontribuon për atë që të mos mund të përgatiten masa përkatëse që do u përgjigjen nevojave të tyre.

Për këtë arsye, është e nevojshme që:

- ▶ Shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë fushë të përfshihen në procesin e përgatitjes dhe miratimit të masave për përballjen me pandeminë dhe efektet negative të pandemisë, të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthortë i referohen personave me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, është e nevojshme që Qeveria të përfshijë shoqatat e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, kurse kjo do të mundësojë edhe ndërlidhjen e tyre, koordinimin e ndërsjellë, bashkëpunimin dhe informimin;
- ▶ Të organizohen takime konsultative me aktorët relevant që drejtëpërdrejtë punojnë në këtë fushë dhe më së miri përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara (për shembull. Procesi i

miratimit të pakove ekonomike për mbështetjen shtetërore financiare ku janë të përfshira dhomat ekonomike, organizata e punëdhënësve dhe sindikatave);

▶ Të gjendet mënyrë për përfshirjen e drejtëpërdrejtë të personave me aftësi të kufizuara dhe/ose përfaqësuesve të tyre në proceset e miratimit të politikave dhe masave. Pandemia ka imponuar nevojën e miratimit të masave dhe rekomandimeve të cilat do të trajtojnë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, dhe rrjedhimisht, masat që i referohen të gjithë popullsisë duhet të jenë të përshatura dhe të ndjeshme në pajtim me nevojat e këtyre personave që kujdesen për ato;

▶ Vazhdimi i praktikës të miratimit të masave me ndikim pozitiv, veçanërisht nëse paraqitet nevoja për shpalljen e sërishme të gjendjes të jashtëzakonshme. Masat e reja duhet të marrin parasysh aspektet që ishin harruar në periudhën e klaur të gjendjes të jashtëzakonshme;

▶ Të gjithë masat për përballjen me krizën duhet të adresojnë rrethanat në të cilat gjenden personat me aftësi të kufizuara, e veçanërisht të merren parasysh rethanat specifike të personave në mjediset rurale;

▶ Mbajtja e statistikës dhe evidencës përkatëse për personat me aftësi të kufizuara dhe përdorimin e saj gjatë proceseve të përgatitjes të masave që do të përgjigjen nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

QASJA NË TË DREJTA DHE SHËRBIME

Masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona në pjesën më të madhe të të anketuarve u kanë shkaktuar vështirësi në funksionimin e përditshëm. Në masë të madhe, ato vështirësi i referohen socializimit të kufizuar dhe lëvizjes të kufizuar, si dhe vështirësve të lidhura me ndjekjen e masave për mbrojtje (mbajtjen e distancës fizike, mbajtjen e maskës, shmangies të grupimeve etj.). Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballur me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjatë pandemisë, prej të cilëve vetëm një numër i vogël janë përballur me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre gjatë pandemisë, prej të cilëve vetëm një grup i vogël janë drejtuar për ndihmë më së shpeshti në qendrat për punë sociale, kurse një numër më i vogël kanë kërkuar ndihmë nga shoqatat qytetare. Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve kanë marrë ndihmën e kërkuar, respektivisht kanë realizuar të drejtat e kërkuara.

Në drejtim të përmirësimit të qasjes të personave me aftësi të kufizuara në të drejta dhe shërbime, propozojmë:

- ▶ Shteti të respektojë detyrimin e tij për përshtatje përkatëse, të paraparë në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, sidomos në raport me eliminimin e vështirësive të lidhura me realizimin e masave të mbrojtjes;
- ▶ Qendrat për punë sociale të jenë të qasshme, të disponueshme dhe të përgjigjen në mënyrë përkatëse në kërkesat e personave me aftësi të kufizuara të cilat kujdesen për to, duke patur parasysh se qendrat janë aktorët më të rëndësishëm të të cilët më të shpeshti drejtohen palët e përfshira;
- ▶ Harmonizimi dhe praktika unifrome e zbatimit të dispozitave që i referohen personave me aftësi të kufizuara.

FINANCAT

Pjesa më e madhe e të anketuarve janë përballur me rritjen e shpenzimeve të përditshme, nga të cilat më së shumti i janë referuar shpenzimeve për mjete higjienike, duke përfshirë edhe mjetet për mbrojtjen nga virusi, shpenzimet për ilaçe dhe shpenzimet për ushqim. Nevoja për prokurimin e suplementeve, siç janë vitaminat më të rëndësishme, për parandalim, por edhe për trajtim të virusit, të cilat nuk ndodhen në listën pozitive të ilaçeve të Fondit për sigurim shëndetësor, në mënyrë shtesë kanë rritur shpenzimet e personave me aftësi të kufizuara. Për ata të cilët terapinë e nevojshme e prokurojnë nga jashtë shtetit, mbyllja e kufijve dhe kufizimet për tejkalimin e tyre u kanë imponuar shpenzime të reja. Një pjesë më e madhe prej tyre ende nuk kanë tejkaluar problemet me shpenzimet. Personat me aftësi të kufizuara nuk ishin përfshirë me masat për ndihmë shtetërore financiare, sidomos personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të aftë për punë. Përveç asaj, pjesa më e madhe e të anketuarve theksojnë mbështetjen financiare si një nga masat që do të ishte më e dobishme gjatë kohës të pandemisë.

Për përmirësimin e gjendjes financiare të personave me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- ▶ Sigurimi i mjeteve higjienike;
- ▶ Sigurimi i ilaçeve dhe suplementëve, si dhe terapi specifike, e cila nuk është në listën pozitive dhe/ose futjen e tyre në listën pozitive të ilaçeve të Fondit për sigurim shëndetësor;
- ▶ Miratimi i masave për ndihmë shtetërore financiare për personat me aftësi të kufizuara, si dhe zgjerimi i shtrirjes të tyre edhe mbi personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të aftë për punë.

ARSIMI

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë përballur me sfida dhe vështirësi gjatë ndjekjes të mësimit onlajn, që nuk ishte përkatës dhe i përshtatur për to dhe për llojet e ndryshme të aftësive të kufizuara. Realizimi i mësimit zhvillohej në mungesë të mjeteve përkatëse ndihmëse arsimore, respektivisht mospasjes të pajisjes të nevojshme teknike për ndjekjen e mësimit (ndihmës arsimor, edukator special etj.). Rrjedhimisht, në fushën e arsimit është e nevojshme:

- ▶ Që të bëhet përshtatja e programeve arsimore në pajtim me nevojat e fëmijëve dhe zhvillimin e planeve individuale për punë me to;
- ▶ Realizimi i mësimit në mënyrë përkatëse me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, dhe kjo nënkupton përshtatjen e nevojave specifike të nxënësve. Përshtatja e mësimit të personave me aftësi të kufizuara (pengesa) sensorike përmes angazhimit të interpretuesit në gjuhën e shenjave;
- ▶ Sigurimi i teknologjisë përkatëse ndihmëse dhe mjete ndihmëse arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për to;
- ▶ Sigurimi i ndihmësve arsimor për punë me fëmijë në kushte shtëpiake.

SHËNDETËSIA

Përshtatjet e bëra në raport me sigurimin e shërbimeve të caktuara shëndetësore, para së gjithash, të lidhura me vazhdimin e vlefshmërisë të dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e ndonjë të drejte nga mbrojtja shëndetësore, nuk ishin të mjaftueshme për realizimin e pandërprerë të mbrojtjes shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara. Një pjesë e madhe e të anketuarve janë përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes shëndetësore gjatë kohës të pandemisë. Personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kujdesen për to janë përballur me fluks dhe pritje të rradhëve në institucionet shëndetësore dhe në farmaci, kurse kjo në mënyrë serioze e rrit rrezikun e infektimit me virus. Në mënyrë shtesë, duke marrë parasysh se një pjesë e personave me aftësi të kufizuara kanë vështirësi në raport me respektimin e masave për mbrojtjen nga virusi, siç është për shembull, mbajtja e maskës, rreziku nga infektimi mund të rritet në mënyrë të konsideruar për to, por edhe për personat tjerë.

Personat me aftësi të kufizuara janë përballur me një numër të madh të kufizimeve gjatë përdorimit të shërbimeve shëndetësore. Institucionet shëndetësore ishin të vendosura tërësisht në funksion të tejkalimit të pasojave nga pandemia, dhe të gjithë kontrollat tjera të vazhdueshme dhe intervenimet ishin shtyrë. Shërbimet për rehabilitim (duke përfshirë edhe masazhat, noti, ushtrimet etj.), të cilat janë të rëndësishme të veçantë për personat me aftësi të kufizuara dhe ndikojnë pozitivisht mbi zhvillimin e tyre, ishin të padisponueshme për një numër të madh të personave me aftësi të kufizuara. Madje edhe sportelet për testimin e KOVID-19 nuk ishin të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Përveç asaj, personat me aftësi të kufizuara dhe personat të cilët kujdesen për to kanë shprehur pakënaqësi në raport me profesionalizimin e punëtorëve shëndetësor dhe mënyrën e komunikimit të ndërsjellë, duke theksuar edhe mosdurimin dhe mosnjohjen e nevojave specifike të cilat i kanë ato.

Me qëllim që të përmirësohet qasja në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara dhe të sigurohet mbrojtja më e mirë shëndetësore, nevojitet:

- ▶ Ndërmarrja e aktiviteteve me të cilat do të organizohet puna e enteve shëndetësore dhe farmacive në mënyrën që në mënyrë përkatëse do të marr parasysh kërkesat e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, nevojitet që të jepet prioritet për personat me aftësi të kufizuara gjatë dhënies të shërbimeve të mbrojtjes shëndetësore, sidomos të atyre që nuk kanë mundësi për shkak të gjendjes të tyre të presin kohë të gjatë dhe/ose në mënyrë përkatëse të respektojnë masat e mbrojtjes;
- ▶ Institucionet shëndetësore të vazhdojnë të funksionojnë për të gjithë kontrollat dhe intervenimet e vazhdueshme, përveç për trajtimin e krizës. Që të sigurohet një numër përkatës i orareve për kontrolla, sidomos në raport me shërbimet shëndetësore nga specialistët;
- ▶ Kthimi në funksion i shërbimeve për rehabilitim në pajtim me protokollat për mbrojtje nga virusi;
- ▶ Spotelet për testim të KOVID -19 të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara;
- ▶ Është e nevojshme që të punohet për ngritjen e vetëdijes të punëtorëve shëndetësorë për punën me personat me aftësi të kufizuara dhe përmirësimin e mënyrës të komunikimit me personat me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh gjendjen e tyre dhe nevojat e tyre specifike.

MBROJTJA SOCIALE

Vetëm një e treta e të anketuarve janë përballur me vështirësi gjatë marrjes të shërbimeve të mbrojtjes sociale gjatë kohës të pandemisë. Një nga problemet më të shpeshta me të cilin janë përballur të anketuarit rrjedh nga pamundësia për shfrytëzimin e shërbimeve të qendrave ditore. Edhe pse, në ndërkohë, qendrat ditore kanë filluar me punë, megjithatë puna e tyre është me kapacitet të kufizuar, kurse transporti deri te qendrat është gjithnjë e më i kufizuar. Profesionalizmi nga ana e personave profesional si dhe organizimi i administratës për sigurimin e shërbimeve të mbështetjes sociale është në nivel të ulët, respektivisht të anketuarit konsiderojnë se ka nevojë për përmirësim në këtë fushë në drejtim të përmirësimit të qasjes në shërbime. Gjatë kohës të pandemisë në mënyrë të konsideruar janë shprehur vështirësitë gjatë grumbullimit dhe ripërtirjes të dokumenteve për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale, dhe kjo në disa raste ka sjellur deri te humbja e të drejtës për shfrytëzimin e tyre. Shërbimet e pazhvilluara për mbështetje sidomos kanë goditur personat me aftësi të kufizuara që jetojnë vet apo me personat më të rritur që kujdesen për to. Korniza e përkufizuar në mënyrë të ngushtë për mbrojtje sociale ka kontribuar që një numër i madh i personave me aftësi të kufizuara që nuk përmbushin kushtet për mbështetje në para, kurse për shkak të krizës kanë mbetur pa të ardhura apo u janë zvogëluar të ardhurat, kanë humbur punën, të përballen me rrezik të rritur social dhe me varfëri.

Rrjedhimisht, është i nevojshëm:

- ▶ Kthimi në funksion të tërësishëm të qendrave ditore me protokolle përkatëse, si dhe të transportit të organizuar të rregullt për përdoruesit;
- ▶ Personat profesional të mbajnë nivel të lartë të profesionalizimit gjatë komunikimit me personat me aftësi të kufizuara dhe të respektojnë kodet etike të punës, me qëllim që të mos dekurajojnë personat me aftësi të kufizuara në shfrytëzimin e shërbimeve të cilat nuk i kanë të disponueshme;

- ▶ Miratimi dhe/ose zbatimi përkatës i protokollëve që do të tejkalojnë problemet me grumbullimin dhe ripërtrirjen e dokumenteve për realizimin e të drejtave të mbrojtjes sociale në drejtim të thjeshtësimit të procedurave;
- ▶ Përfshirja e mundësisë për ripërtrirjen elektronike dhe dorëzimin e dokumentacionit të tërësishëm për realizimin e të drejtës nga mbrojtja sociale;
- ▶ Zhvillimi i shërbimeve për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara të cilët janë në rrezik të rritur social dhe varfëri.

TREGU I PUNËS

Vështirësitë me të cilat janë përballur të anketuarit në vendin e punës gjatë kohës të pandemisë në pjesën më të madhe i janë referuar mungesës nga puna për shkak të kujdesit për personin me aftësi të kufizuara në shtëpi. Përveç kësaj, këtë vit me vështirësi të veçanta për angazhimin në punë përballen personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në mjedisin rural dhe që janë përkohësisht të angazhuar si punëtorë sezonal, duke patur parasysh atë se është zvogëluar prodhimi dhe eksporti i produkteve jashtë shtetit. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme:

- ▶ Kthimi në funksion i kapaciteteve të tërësishme të shërbimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në drejtim të sigurimit të mbështetjes për personat që kujdesen për to dhe janë të përfshirë në tregun e punës. Njëkohësisht, në kushte të kufizimeve të përsëritura të këtij lloji, është e nevojshme që të parashihen protokollët përkatëse për funksionimin e shërbimeve në kushtet e dhëna;
- ▶ Krijimi i masave përkatëse që do u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara që të mbajnë vendet e tyre të punës në kushte të krizës të këtij lloji;

- ▶ Gjatë krijimit të masave të reja të mendohet në drejtim të zbutjes të pasojave që na presin së shpejti.

QASJA, TRANSPORTI, DHE LËVIZSHMËRIA

Problemi i qasjes të kufizuar apo të vështirësuar në institucionet me të cilat në përditshmëri përballen personat me aftësi të kufizuara është shprehur në mënyrë të konsideruar gjatë kohës të pandemisë. Kjo i referohet funksionimit të reduktuar të institucioneve dhe kufizimit të transportit gjatë kësaj periudhe. Një pjesë e personave nuk kishin mundësinë që të shfrytëzojnë transportin publik për shkak të pamundësisë që në tërësi të respektojnë masat për mbrojtje nga virusi. Vetëm një pjesë e vogël e institucioneve në tërësi janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Përveç asaj, është shqetësuese se institucionet nuk përgjigjen në nevojat e personave me nevoja të veçanta. Ndërtesat në pjesën më të madhe të institucioneve janë fizikisht të paqasshme për personat me aftësi të kufizuara. Institucionet nuk kanë interpretues të disponueshëm në gjuhën e shenjave për personat me dëgjim të dëmtuar. Institucionet nuk kanë interpretues të disponueshëm në gjuhën e shenjave për personat me dëgjim të dëmtuar. Objektet e institucioneve nuk janë shënuar me shkrimin Brajl, dhe as informatata që lidhen me shërbimet janë të disponueshme në shkrimin Brajll. Institucionet nuk kanë ueb-faqe të cilat janë të përshtatura për kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Në drejtim të përmirësimit të qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, nevojitet:

- ▶ Të sigurohet dhe të garantohet funksionimi i pandërprerë i institucioneve, me qëllim që të mos kufizohet qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbime;

- ▶ Të sigurohet transport i rregullt publik, por edhe transport special për personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë prej tij apo mënyra alternative për transport në qytetet ku nuk ka transport publik të organizuar;
- ▶ Institucionet t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të personave me nevoja të veçanta dhe të sigurojnë qasje përkatëse deri në objekte, por edhe në hapësirat e objekteve;
- ▶ Institucionet të sigurojnë interpretues në gjuhën e shenjave të cilët do të ishin lehtësisht të qasshëm dhe në dispozicion;
- ▶ Objektet e institucioneve të shënohen me shkrimin Brajl dhe informatat të cilat i ndajnë duhet të jenë të disponueshme dhe në shkrimin Brajl;
- ▶ Ueb-faqet e institucioneve të jenë të përshtatura për kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara;
- ▶ Informatat që shpërndahen përmes shërbimit publik, veçanërisht përmes lajmeve, të jenë të disponueshme edhe për personat me aftësi të kufizuara.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

Agjencia e punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2021). *Pasqyra e të dhënave për hyrjet dhe daljet e personave të papunë*. E disponueshme në: <https://av.gov.mk/pregled-na-podatoci-za-priliv-i-odliv-na-nevraboteni-lica.nsp.x>.

Jadrovski, I., Čallovska Dimovska, N. Dhe Jovanovska Kanurkova, J. (2018). *Raporti për ndihmën juridike të siguruar, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut*. I disponueshëm në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/IZVESTAJ_ZA_PRAVNA_POMOS.pdf.

Jovanovska, B. (2020). *Përforcimi juridik në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: raport*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/finalen-izveshta%D1%98-uniczef-mk.pdf>.

Kočoska, E. dhe të tjerë (2017). *Analiza e gjendjes me personat me aftësi të kufizuara fizike në Republikën e Maqedonisë*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. E disponueshme në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Анализа-на-состојбата-на-лицата-со-физичка-попреченост-во-Република-Македонија.pdf>.

Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (2020). *Gjendja e jashtëzakonshme 18.03.2020 – 22.06.2020 pasqyra e Dekreteve të miratuara me fuqi ligjore*. E disponueshme në: <https://bit.ly/3a09oSL>.

Mihajlova, N., Ilieva, D., Mihajlov, S., dhe Jovanova Jandrijevska, K. (dhjetor, 2015). *Плнерësimi i formave alternative të kujdesit dhe shërbimet për mbështetjen e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara*. UNICEF. I disponueshëm në: <https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3731/file>.

Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (Mars, 2020). *Raporti i veçantë nga hulumtimi i realizuar për gjendjen e realizimit të të drejtës të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. I disponueshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2020/Poseben%20izvestaj-Deca%20so%20poprecenost-2020.pdf>.

Ortakovski, T. *Analiza e vlerësimit të programeve dhe masave nacionale për punësimin e personave me aftësi të kufizuara*. Misioni i OSBE në Shkup. E disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/7/5/372051.pdf>.

Petkovska N. (30 nëntor, 2020). *Pasqyra e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi korona dhe ndikimi i tyre mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. I disponueshëm në <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenczi%d1%98a-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%d1%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

Popovska, ZH. dhe të tjerë (2015). *Ligjet dhe politikat në Republikën e Maqedonisë në fushën e aftësive të kufizuara*.

Popovska, ZH. (2018). *Interpretues në Konventën ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësitë e kufizuara në Organizatën e Kombeve të Bashkuara*. E disponueshme në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/tolkuvac-un_konvencija.pdf.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (26 mars, 2020). *Disability considerations during the COVID-19 outbreak*. E disponueshme në: <https://www.who.int/publications-detail/disability-considerations-during-the-covid-19-outbreak>.

Sekretariati për Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. *Overview of International Legal Frameworks For Disability Legislation*. United Nations. E disponueshme në: <https://www.un.org/esa/socdev/enable/disovlf.htm#overleg2>.

Haxhi-Zafirov, ZH. (17 nëntor, 2020). *Analiza e dekretëve të miratuara me fuqi ligjore gjatë gjendjes të jashtëzakonshme në vitin 2020*. Grupi bluprint për refroma në gjyqësor. E disponueshme në: http://blueprint.org.mk/wp-content/uploads/2020/11/Анализа-на-донесените-уредби-со-законска-сила-за-време-на-вонредната-состојба-во-2020_Блупринт.pdf.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut. *Infografik për aftësitë e kufizuara fizike*. I disponueshëm në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/INFOGRAFIK_fizicka_poprecenost_04-01_3_.pdf.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut (13 tetor, 2020). *Raporti i veçantë për gjendjen me të drejtat e njeriut gjatë Kovid -19*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshta%d1%98-za-sosto%d1%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>.

Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave (15 prill, 2020). *Kovid 19 dhe gjinia (botimi i dytë)*. E disponueshme në: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/>.

LEGJISLACIONI

Organizata e Kombeve të Bashkuara (10 dhjetor, 1948). *Deklarata univertzale për të drejtat e njeriut*.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (21 dhjetor, 1965). *Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit racor*. Ka hyrë në fuqi në 4 janar të vitit 1969.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (16 dhjetor, 1966). *Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*. Ka hyrë në fuqi në 3 janar të viti 1976.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (16 dhjetor, 1966). *Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike*. Ka hyrë në fuqi në 23 mars të vitit 1976.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (18 dhjetor, 1979). *Konventa për eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit mbi gratë*. Ka hyrë në fuqi në 3 shtator të vitit 1981.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (4 shkurt, 1985). *Konventa kundër torturës dhe veprimit apo dënimit tjetër mizor, çnjerëzor apo poshtërues*. Ka hyrë në fuqi në 26 qershor të vitit 1987.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (20 nëntor, 1989). *Konventa për të drejtat e fëmijës*. Ka hyrë në fuqi në 2 shtator të vitit 1990.

Organizata e Kombeve të Bashkuara (18 dhjetor, 1990). *Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrant dhe anëtarëve të familjeve të tyre*. Ka hyrë në fuqi në 1 korrik të vitit 2003.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, (13 dhjetor, 2006). *Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Ka hyrë në fuqi në 3 maj të vitit 2008.

Kuvendi i Republikës të Maqedonisë (17 nëntor, 1991), *Kushtetuta e Republikës të Maqedonisë*. E shpallur me vendim nr 08-4642/1. Neni 118.

Kuvendi i RM (3 mars, 2000). *Ligji për sigurim shëndetësor*. "Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë " b.p. 25/00, 34/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37/06, 18/07, 36/07, 82/08, 98/08, 6/09, 67/09, 50/10, 156/10, 53/11, 26/12, 16/13, 91/13, 187/13, 43/14, 44/14, 97/14, 112/14, 113/14, 188/14, 20/15, 61/15, 98/15, 129/15, 150/15, 154/15, 192/15, 217/15, 27/16, 37/16, 120/16, 142/16, 171/17 dhe „Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 275/19 dhe 77/21.

Kuvendi i RM (2 qershor, 2000). *Ligji për punësimin e personave invalidor*. "Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë" nr. 44/00, 16/04, 62/05, 113/05, 29/07, 88/08, 161/08, 99/09, 136/11, 129/15, 147/15, 27/16 dhe 99/18.

Kuvendi i Republikës të Maqedonisë (5 dhjetor, 2011). *Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me invaliditet dhe Protokollin fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e personave me invaliditet*. "Gazeta zyrtare e RM" numër 172 nga 14 dhjetori i vitit 2011.

Kuvendi i RM (29 mars, 2012). *Ligji për mbrojtjen shëndetësore*. "Gazeta zyrtare e RM" nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16, 20/19 dhe „Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 101/19, 153/19, 180/19, 275/19 dhe 77/21.

Kuvendi i RMV (23 maj, 2019). *Ligji për mbrojtjen sociale*. "Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut " nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20 dhe 311/20.

Kuvendi i RMV (30 tetor, 2020). *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*. "Gazeta zyrtare e RMV". nr. 258/2020 dhe 30.10.2020.

